

Programi

Konsultime me artistë kosovar
mbi themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e
fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të
të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi (KOMRA)

(10.05.2009. Hotel „Grand“, Prishtinë)

- 10:00 – 10:10 **Hapja**
Sarah Maliqi, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, anëtare e
Koalicionit për themelimin e KOMRA-s
- 10:10 – 11:45 **Prezantimi i iniciativës për themelimin e KOMRA-s**
- Qëllimi dhe rrjedha e konsultimeve
 - Përse KOMRA?
- Natasha Kandiç, Këshilli koordinues i Koalicionit për KOMRA
Haris Pashović, profesor dhe regjisor, Akademia e Arteve Skenike,
Sarajevë
Salem Çorbo, Shoqata “Kthimi dhe ekzistenca e qëndrueshme”,
Bosnje dhe Hercegovinë
Diskutime
- 11:45 – 12:00 **Pauza**
- 12:00 – 13:30 **Shfaqja e filmit “Ballafaqimi me të kaluarën”: Komisionet për të
vërtetën dhe shoqëritë në tranzicion**
Diskutime
Moderatore: Sarah Maliqi
- 13:30 – 14:00 **Konkluzionet: Komentet dhe propozimet**
Zhvillimi dhe rekomandimet
Moderatore: Sarah Maliqi
- 14:00 – 15:00 **Dreka**

Pjesëmarrësit:

1. Visar Krusha - Dramaturg
2. Zana Hoxha-Krasniqi- Rezhisore
3. Arben Zharku - Artist
4. Eli Krasniqi - Sociologe
5. Ilir Gjocaj – Dramaturg
6. Albert Heta - Stacion
7. Petrit Çarkaxhiu - Oxygen
8. Arif Muharremi – Balkan Investigative Reporting Network (Birn)
9. Doruntina Basha – Dramaturg
10. Ilir Bajri - Kompozitor

Vëzhguesit:

1. Ylber Maxhuni - Youth step
2. Nora Ahmetaj – Bordi Fondi për të Drejtën Humanitare
3. Bogdan Ivanisheviq– Internation Center for Transitional Justice
4. Haki Abazi –Rockefeller Brothers Fund
5. Agon Vrenezi – Office of the High Commissioner for the Human Rights
6. Shqipe Mula – Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR) aktivist
7. Bujar Qerreti – YIHR aktivist
8. Granit Sylejmani – YIHR aktivist
9. Guri Gashi – YIHR aktivist
10. Vjosa Rexhepi - YIHR
11. Adrijana Petrović – YIHR
12. Lorik Rrustemaj – YIHR aktivist
13. Mentor Agani – Profesor
14. Driton Hoxha – YIHR aktivist
15. Donika Shala – YIHR aktivist
16. Besnik Leka – YIHR
17. Jeta Jusufi – YIHR
18. Donjeta Murati – YIHR
19. Alban Ukaj – SARTR
20. Sakibe Jashari – Ambasada zvicerane
21. Nazim Bahtiri - Youth step
22. Avni Melenica – 22 Maji

Panelistët dhe organizatorët:

1. Haris Pashoviq – Rezhisor, East West centar
2. Natasha Kandiç- FDH
3. Sarah Maliqi -YIHR
4. Salem Čorbo – Shoqata “Povratak i održiv opstanak”
5. Jelena Grujić - FDH
6. Bekim Blakaj – FDH, Kosovë

7. Shukrije Gashi – Partners Kosova
8. Besarta Vasija - FDH, Kosovë
9. Raba Gjoshi – YIHR
10. Besarta Lumi – YIHR

Hapja e mbledhjes:

Sarah Maliqi: Mirëmëngjesi, së pari më lejoni tju përshëndes në emër të organizatorit të këtij konsultimi, Iniciativës të të rinjve për të drejtat e njeriut dhe koalicionit për themelimin e komisionit rajonal. Para se të filloj tju përshëndes, mua më vije keq që një numër i madh i pjesëmarrësve nuk kanë ardhur, me keqardhje të madhe, shumë më vije keq, por po fillojmë me ne që jemi këtu. Sot ju kemi ftuar që të bisedojmë për nevojat dhe përvojat, më falni pritjet e shoqërisë në lidhje me të kaluarën e afërt dhe të bisedojmë në lidhje me propozimet konkrete për idenë e themelimit të një komisioni rajonal për përcaktimin e fakteve për krime të luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi. Personalisht pasi që vij nga një organizatë rajonale por edhe besoj në një qasje rajonale për ballafaqimin me të kaluarën është shumë me rëndësi që kjo iniciativë është rajonale. Ky debat është i rëndësishëm për shkak të demokratizimit të Kosovës mirëpo po ashtu ka për të kontribuar në ndërtimin e shoqërisë. Nuk mund të ketë sundim të ligjit pa parë se çka ka ndodhur në të kaluarën, pa një drejtësi për viktimat dhe reparacion për viktimat. Besoj se nuk do të ketë të ardhme për gjeneratat tona e as të ardhshmet nëse nuk sigurojmë që krimet e bëra në Kosovë nuk do të përsëriten më kurrë. Para se tja jap fjalën panelistave, unë kisha me ju thirr që të flisni hapur, pa hezitime dhe të pyetni për çka do që keni të pa qartë dhe shpresoj që në fund të ditës mund të dalim me disa konkluzione të cilat do të ndihmojnë dhe kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e debatit mbi mekanizmat e drejtësisë transicionale këtu në Kosovë. Së pari, ne kemi, si të them, adet që të fillojmë të prezantohemi të gjithë në sallë, kështu që ndoshta kisha filluar prej anës sime në të djathtë me zotëri Harisin.

Haris Pashoviq: Mirëdita të gjithëve! Me të vërtetë më vjen mirë që sot unë gjendem këtu duke ju falënderuar së pari Natasha Kandiq e pastaj dhe vendasve të cilët më kanë ftuar. Unë me të vërtetë jam i privilegjuar të gjendem sot këtu për dy arsye. Njëra është që jam duke shkuar ku shkon dhe Natasha Kandiq, kur mundem, deri ku unë mundem, e ajo mundet më shumë se që mundem unë, kështu që unë mundem vetëm ta përcjell në këtë rrugë. Arsya e dytë është se moti skam qenë në Prishtinë por i kam përcjell të gjitha ngjarjet në 20 dhe më shumë vite të fundit, por nuk kam pasur rast të vijë këtu dhe ky ka qenë një arsye e rëndësishme dhe për atë i kam lënë të gjitha edhe pse jam në një periudhë të punës time intensive dhe kam menduar që të gjitha munden me prit dhe jam me të vërtetë i gëzuar sepse jam sot këtu.

Salem Ćorbo: E përshëndes tubimin. Unë jam Salem Ćorbo. Vijë nga Bjelina -Bosnja dhe Hercegovina. Dhe duke ju falënderuar ndërlidhjes regjionale disa herë jam duke ardhur këtu në Kosovë, në Prishtinë.

Nora Ahmetaj: Unë jam Nora Ahmetaj. Para dhe pas luftës kam punuar për Fondin për të Drejtën Humanitare. Tash edhe jam anëtare e Bordit, mirëpo këtu jam në cilësinë thjesht si qytetare e Kosovës dhe jam shumë e interesuar lidhur me të drejtën tranzitore dhe Konfliktin rezoluesion.

Bogdan Ivanisheviq: : Mirëdita! Unë jam Bogdan Ivanisheviq, nga Qendra Ndërkombëtare për drejtësinë tranzicionale ITCJ është një organizatë jo qeveritare me seli në New York. Unë jetoj dhe punoj në Beograd. Dhe siç thotë dhe vetë titulli i organizatës, ajo merret me të gjitha aspektet e drejtësisë tranzicionale... dhe komisionit për të vërtetën në mënyra të ndryshme e në këtë iniciativë për themelimin e Komisionit Regjional për përcaktimin e fakteve dhe shkeljet e drejtave të njeriut dhe drejtën humanitare në hapësirat e ish Jugosllavisë. Organizata është e përfshirë drejtpërsëdrejti domethënë, ne jemi organizata nga regjioni, nuk jemi anëtarë të koalicionit për themelimin e komisionit por me ndihmën e ekspertëve ose me çdo formë të bashkëpunimit tërthorazi – indirekt jemi të inkuadruar në këtë iniciativë.

Visar Krusha: Unë jam Visar Krusha. Jam dramaturg dhe regjisor. Jam pjesëmarrës.

Zana Hoxha Krasniqi: Mirë dita! Unë jam Zana Hoxha – Krasniqi. Jam regjisore e teatrit. Jam shumë e interesuar për të drejtat e njeriut dhe në veçanti përdorimin e teatrit si mjet për trajtimin e çështjeve sociale në Kosovës, kështu që mezi po e pres konferencën. Faleminderit!

Arben Zharku: Unë jam Arben Zharku. Jam aktor dhe punoj edhe si producent. Si aktor ose kudo që më jepet mundësia kam qejf të flas për të drejtat e njeriut dhe për pasojat që i ka lënë konflikti në ish-Jugosllavi dhe me kënaqësi sot do të diskutojmë dhe dëgjojmë për çështjet për çka jemi të thirrur. Faleminderit!

Eli Krasniqi: Jam Eli Krasniqi, sociologe.

Ilir Gjocaj: Unë jam Ilir Gjocaj. Jam dramaturg dhe regjisor.

Avni Melenica: Përshëndetje! Unë jam Avdi Melenica, vije në cilësi të vëzhguesit. Përndryshe, jam kryesues i Shoqatës Familjare të Personave të Zhdukur, në Vushtrri “22 maji”.

Ylber Maxhuni: Përshëndetje, të gjithëve! Unë quhem Ylber Maxhuni, jam përfaqësues i Organizatës “ju step” nga Vushtrria – Organizatës rinore. Ju përshëndes të gjithë të pranishmit, mysafirët veçanërisht të ditës së sotme. Jam në cilësinë e vëzhguesit sot dhe jemi përkrahës të Komisionit Komra.

Nazim Bahtiri: Përshëndetje të gjithëve! Unë jam Nazim Bahtiri, jam student i gazetarisë, vije nga Vushtrria. Po ashtu, jam pjesë e një Organizate rinore e cila merret me të drejtat e njeriut. Ju përgëzoj për aktivitetin që e keni marrë në këtë rast. Mendoj se do ta keni përkrahjen time. Faleminderit!

Adrijana Petrović: Ju përshëndes të gjithëve. Unë jam Adrijana Petroviq. Momentalisht jam duke punuar në Iniciativë të rinjve për të drejtat e njeriut diçka si intership, që disa muaj. Vetëm mund të them që kam kënaqësi që marr pjesë dhe që punoj me kësi njerëz të rinj të mirë dhe persona të mençur. Kaq pata.

Agon Vrenezi: Mirë mëngjes! Unë jam Agon Vrenezi, jurist. Aktualisht punoj në Komisariatit e Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Përndryshe, jam personalisht i lidhur me këtë iniciativë që nga forumi i parë në Sarajevë dhe, pa marrë parasysh ku kam punuar, vazhdimisht kam qenë pjesë e aktiviteteve të kësaj iniciative. Faleminderit!

Jelena Grujić: Mirëdita! Unë jam Jelena Grujić, kam qenë gazetare 11 vite, por që një muaj punoj në Fondin për të Drejtat e Njeriut.

Bujar Qerreti: Jam Bujar Qerreti! Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut.

Driton Hoxha: Jam Driton Hoxha, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut.

Granit Sylejmani: Jam Granit Sylejmani, student i Departamentit të Shkencave Politike, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, gjithashtu edhe aktivist i Nismës për të drejtat e njeriut.

Guri Gashi: Jam Guri Gashi, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut.

Albert Heta: Jam Albert Heta, artist.

Doruntina Basha: Jam Doruntina Basha, dramaturge.

Petrit Çarkaxhiu: Jam Petrit Çarkaxhiu, me profesion arkitekt, por s'më kanë thirr si arkitekt, sot jam ... i rok bendit Xheriko. Gjithashtu jam koordinator i projekteve për Organizatën joqeveritare Oksigjen, përfaqësues i Rrjetit të Radiostacioneve dhe organizatave kros-radio që vijnë prej vendeve të ish-Jugosllavisë.

Bekim Blakaj: Jam Bekim Blakaj, udhëheqës i Zyrës së Fondit për të drejtën humanitare në Kosovë.

Haki Abazi: Jam Haki Abazi, përfaqësues i Fondacionit të vëllezërve Rockefeller për Ballkanin Perëndimor.

Shukrije Gashi: Jam Shukrije Gashi, drejtoreshë e Qendrës për Administrimin e Konfliktëve "Partners-Kosova". Jam edhe anëtare e Këshillit koordinues të koalicionit KOMRA. Kam pas nderin dhe kënaqësinë që të marr pjesë në disa këshillime që janë organizuar në ish-vendet e Jugosllavisë, duke përfshirë edhe Kosovën dhe them se është një iniciativë shumë e qëlluar dhe e nevojshme. Në disa prej këshillimeve që kam marrë pjesë në Kosovë dhe në Beograd kam pa se numri i të rinjve është i madh për përkrahjen e koalicionit, për faktin se drejtësia tranzicionale është më se e nevojshme kudo qoftë në ish-Jugosllavi, në radhë të parë për hir të viktimave të cilave u nevojitet një pranim publik dhe thjeshtë vendosjen e drejtësisë, domethënë dënimin e kryerësve të veprave penale. Faleminderit!

Natasha Kandić: Unë jam Natasha Kandić, anëtare e Këshillit koordinues koalicionit për KOMRA-n. Kisha dashur vetëm një korrigjim lidhur me emër sepse është duke u përsëritur edhe dje por edhe sot. Nga Bosnja dhe Hercegovina na vjen Salem Čorbo, i cili është edhe dje edhe sot në funksion të reprezentimit të idesë dhe iniciativës për KOMRA, por dhe sot dhe dje mbiemri i tij shkruhet Čorba, çka në gjuhën serbe do të thotë çorbë-supë. Dhe ky nuk është ndonjë çorbë por quhet Čorbo. Dhe dje kam pasur problem me këtë, kur e kam ndier përkthyesin i cili e përsëriti disa herë zotëri Čorba. Tani shoh se i mjeri prapë e ka kryer sikur dje, për atë ju lus të gjithë ta keni të qartë, mbiemri i tij është Čorbo.

Salem Čorbo: Unë jam Natasha Kandić, anëtare e Këshillit koordinues koalicionit për KOMRA-n. Kisha dashur vetëm një korrigjim lidhur me emër sepse është duke u përsëritur edhe dje por edhe sot. Nga Bosnja dhe Hercegovina na vjen Salem Čorbo, i cili është edhe dje edhe sot në funksion të reprezentimit të idesë dhe iniciativës për KOMRA, por dhe sot dhe dje mbiemri i tij shkruhet Čorbo, çka në gjuhën serbe do të thotë çorbë-supë. Dhe ky nuk është ndonjë çorbë por quhet Čorbo. Dhe dje kam pasur problem me këtë, kur e kam ndier përkthyesin i cili e përsëriti disa herë zotëri Čorba. Tani shoh se i mjeri prapë e ka kryer sikur dje, për atë ju lus të gjithë ta keni të qartë, mbiemri i tij është Čorbo.

Sarah Maliqi:Faleminderit! Faktikisht ne kemi bërë një ndryshim të vogël në agjendë prej asaj që kam dërguar në ftesë. Të gjithë e keni tash para vetes agjendën e re dhe së pari, do t'ia jap menjëherë fjalën dhe faktikisht po e hapim Konferencën ku Natasha Kandić, Haris Pashović dhe Salem Čorbo do të flasin për iniciativën për themelimin e KOMRES pak më shumë, e pastaj vazhdojmë me diskutime. Më pastaj, do të shfaqim një film, i cili i tregon e vërtetës në Maroko. Më falni! A po dëgjohet? Jo!

(Ndërprerje e incizimit)

Natasha Kandič: Kjo nuk është temë as e politikanëve, as temë në parlament, kjo nuk është temë as e mediave. Me të kaluarën merren shoqatat e familjarëve të viktimave në qarqet e tyre të ngushta. Nganjëherë ata mbledhen për të shënuar datën kur janë kryer krimet dhe pastaj lajmërohen edhe politikanët dhe pas saj të gjitha ecin me të vjetrën. Kjo temë për të kaluarën më nuk ekziston. Ka gjykime për krime lufte në Hagë, por nuk është më temë e madhe, por nuk është as temë e rëndësishme në as në ndonjë shoqëri të ish Jugosllavisë. Mësojmë, mediat na informojnë, sa është dikush i dënuar, si reagon opinionin ndaj vendimit, por nuk ka debat. Edhe t'u përkujtoj, para një muaj e gjysmë është shqiptuar njëri nga dënimet më të rëndësishme. Më të rëndësishmit, përfaqësues më të lartë të autoriteteve të Serbisë janë dënuar për krime në Kosovë. Të gjithë, me përgjegjësinë e komandës. Është liruar presidentit, atëherë presidenti i Serbisë, Milan Milutinović, por të gjithë gjeneralët, duke përfshirë zëvendës presidentin e Qeverisë Federative janë të dënuar me dënime të larta dhe definitivisht me këto aktvendime janë themeluar faktet në lidhje me atë që ndodhi në Kosovë, çka kanë bërë policia dhe ushtria e Republikës së Serbisë në Kosovë, janë themeluar faktet të pa kontestueshme dhe përgjegjësinë për dëbim, për depërtim për vrasjet masive për ndërmarrje e krimeve të përbashkëta që kishin për qëllim për të vrarë dhe me deportim ta ndryshojnë strukturën e Kosovës. Por, as në Serbi, sa kam ndjekur, as në Kosovë nuk ka qenë kjo temë dhe me të vërtetë, shtohet pyetja: çfarë është duke ndodhur në tërë këto shoqëri, në qoftë se asnjë aktvendim, i cili flet për atë, përcakton faktet dhe përgjithmonë i vënë në nivel të fakteve të pakontestueshëm - nuk shkakton ndonjë vëmendje, as politikës, as mediave, as opinionin nuk është i interesuar në përgjithësi për të hapur një debat në lidhje me të. E, për shkak se një situatë të tillë, sepse nuk ka asnjë interes, asnjë interes zyrtar ose të interesit publik për të kaluarën për të hapur debatin, organizata për të drejtat e njeriut nga ish-Jugosllavia si një organizatë e të drejtave të njeriut në shoqëritë tjera, në tjera shoqëri post konflikte dhe post totalitare e kanë nisur një iniciativë që e kaluara është në rendin e ditës, dhe për të shqetësuar vazhdimisht opinionin dhe politikanët në përpjekje për të hapur dhe të zhvillojmë një debat në nivel rajonal i cili do të jep disa rezultate, rezultatet në lidhje me atë që ne e konsiderojmë të rëndësishme. Ajo që ne mendojmë se është e rëndësishme, është vlerësimi specifik i yni çka është e rëndësishme, çka kemi mësuar nga përvojat e të tjerëve se si të krijojmë drejtësi pas konfliktit të armatosur. Dhe iniciativa e jonë është pjesërisht e bazuar në përvojën e atyre, por gjithashtu jemi kujdesur që ish Jugosllavia, ajo çka ka ndodhur, duke filluar nga viti 1991, por më specifike që ne nuk mund të gjejmë një shembull të ngjashëm. Ne mund të përdorim përvojën e të tjerëve, por ne duhet ta krijojmë një model të veçantë mbi marrëdhëniet në të kaluarën, sipas mbizotërimit e së kaluarës, dhe kështu lindi ideja që dhe ne të provojmë të ndërtojmë Komisionin, të propozojmë që ne të ndërtojmë se si duhet të duket dhe në fund ajo të jetë jo përgjigja e jonë, sepse ne si shoqëri civile, si organizata për të drejtat e njeriut, si të gjithë ata që marrin pjesë në këto konsultime, ata nuk mund të japin fuqinë kësaj iniciativës që të realizohet, që ajo të merr fuqi për ta pranuar të gjitha shtetet. Pra, ne të gjithë që e përbëjmë këtë koalicion për formimin e komisionit rajonal ne mund të organizojmë këto konsultime, për të ftuar grupe të ndryshme të shoqërisë civile të na bashkëngjiten në këto konsultime, për të menduar, për të propozuar se si fakt duhemi të sillemi ndaj së kaluarës, si të ndërtojmë një marrëdhënie të përgjegjshme që mund të ndihmojë për të mos u përsëritur kurrë më këto krime në Ballkan - në rajon. Edhe pse ideja e ka origjinën nga disa organizata, ajo çka është e rëndësishme, sot është se idenë e përfaqësojnë një numër i madh i organizatave dhe individëve, dhe ne, të cilët jemi anëtarë të

Anëtarët e koalicionit, gjithmonë kanë nevojë për më shumë njerëz dhe organizata që përfaqësojnë idenë e themelimit të Komisionit rajonal për tu bashkangjitur konsultimeve dhe mos të lejojnë, së bashku me neve, që çështja e kaluarës, çështja e përcaktimit të fakteve, nevoja që faktet të dalin në opinion, që në nivel rajonal, tregohen të paktën një minimum fakte si një themelimi, të them si një kuantum i fakteve të cilat më askush nuk mund ti mohoj, i cili do të duhet të hyjë në programet arsimore. Pra, si ne që e kishim kaluarën e të përbashkët. Këtë, kaluarën e përbashkët duhet ta nënvizojmë me një vijë por duke pasur faktet të themeluara dhe të qarta se çka ka ndodhur në të kaluarën dhe se kjo e kaluara, duke ju falënderuar a saj që do të jetë krejtësisht e mbushur me fakte, dhe të shërbejë si një mësim i mirë si dhe një mësim i mirë për të gjithë brezat e ardhshëm. Për të qenë krejtësisht e qartë se pse ne jemi përgjegjës, pse janë të tjerët përgjegjës, pse ne nuk kemi mundur asgjë të ndërpreme, cili është roli i jonë i përgjegjësishë, por edhe artistëve të rinj do ta kanë hapësirën për të parë dhe njohur se cili është roli i tyre në të kaluarën dhe në lidhje me ndërtimin e nevojshme dhe kujtimin e kujtesës historike në lidhje me atë që ndodhi. Sot, konsultime të këtij lloji zhvillohen në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Kemi ndërmend të zgjerojë organizimin dhe në Maqedoni dhe Slloveni, por duket se është ende herët, ne kemi kohë ...shumë për shkak se është një plan i yni, plani i koalicionit që në qershor të vitit të ardhshëm ti organizojmë këto debate rajonale, të udhëheqim debate brenda shteteve. Pastaj, prej qershorit vitit 2010 fillojmë me mbledhjen e nënshkrimeve, ne duam 1 000 000 nënshkrime si një mbështetje si një manifestim i legjitimitetit e të gjithë veprimtarisë tona rreth iniciativës për të krijuar KOMRA-n. Deri në fund të vitit do ta ndërtojmë një model të Komisionit Rajonal të cilin pastaj do ta dërgojmë qeverive nacionale, Qeveris në Kosovë, Qeveris së Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë dhe pastaj presim që qeveritë nacionale e vejnë në rendin e ditës të parlamentit iniciativën dhe pastaj presin që ajo të jetë e pranuar dhe në fund të ketë përgjigje të një organi politik dhe shoqëritë përgjegjëse të cilat të kaluarën e dëshirojnë plotësisht të hapura për opinion dhe të përdorimit të së kaluarës për të ndërtuar një të ardhme demokratike, por që të gjitha marrin pjesë me njëfarë mënyre përgjegjësin. A është ky veprim që do të mbetet në nivelin e veprimit që nuk do të arrihet? Janë ata që e parashtrojnë këtë pyetje dhe thonë: " A ka vlerë kjo përpjekje me kaq shume kësi diskutimesh dhe në fund qeveritë, parlamentet nuk e miratojnë këtë nismë. Unë i shoh dy gjëra shumë të rëndësishme në lidhje me këtë iniciativë. Këto konsultime sot, dje, javën e shkuar ato ishin në Beograd, kanë qenë në Srebrenicë, para kësaj në Bijelinë më përpara ishin në Rjekë. Këto debate janë shumë të rëndësishme. Siç thashë në fillim mos të ishin këto debate nuk do të flitej fare për të kaluarën, askush nuk do të vente pyetjen - çfarë ka ndodhur, eja të përcaktojmë se çfarë ka ndodhur, a mundemi ne të themi se ne e dimë pikërisht atë çka ka ndodhur. Shoqata e familjeve të viktimave, ata kanë tendencë për të thënë - ne e dimë se çfarë ka ndodhur. E dinë, secili në një nivel lokal. Megjithatë, jashtë nivelit lokal, jashtë Krushës e Madhe, njerëzit e din plotësisht çka ka ndodhur atje janë djegur njerëzit –njëqind dhe më shumë në një ndërtesë, por a i dinë emrat e tyre. Nuk ka as një politikan apo gazetarët që në kokën e tyre e kanë një emër të viktimës. E kjo është ajo që ne duam në këtë proces konsultativ të tregojmë se ato viktima janë të rëndësishme dhe ne mendojmë se është e rëndësishme që të tregojnë publikisht se ata janë të rëndësishëm. Dëshirojmë që viktimat të jenë mbi përkujtimoret nuk dëshirojmë që ato të jenë vetëm numra. Ne duam që çdo viktimë të ketë emrin dhe mbiemrin e tij, që të ketë identitetin e tij. Ne duam të ndërtojmë qendrën përkujtimore. Ne duam që komemorimi i të kaluarës të jetë mbi monumentet përkujtimore,

për të bërë një ... për të ndërtuar një kulturë të kujtesës, të kujtesës për atë që ndodhi. Më vjen shumë keq sepse ka ndodhur këtu në Kosovë dhe ju nuk keni pasur mundësi për të parë se çfarë u organizua më datën 28 Mars në Podujevë. Me siguri keni dëgjuar se më 28. Mars 1999. që pjesëtarët e njësisë të posaçme të policisë serbe të MPB, ashtu quajtur "Shkorpionët" brenda një ore pas mbërritjes në Podujevë, i kanë vrarë 14 gra dhe fëmijë, që pesë fëmijë janë rënd të plagosur dhe ata fëmijë edhe sot, disa prej tyre janë vajza, kanë pasoja të përhershme, asaj siç kishin thonë në Serbi: "luftës mbrojtëse për Serbinë." Thuhet, policia serbe e ka mbrojt Serbin nga agresioni i NATO-s. " Këta fëmijë sot jetojnë në Mançester. Kanë kaluar operacione të shumta, por pasojat e plagosjes dhe sot ekzistojnë. Por, Mançester është një qytet i çuditshëm ku një nismë qytetare ishte një gjë, për të thënë se sa një qytetar privatisht është i gatshëm të angazhohet për të tjerët, për shkak të tjerëve. Ndoshta është në pyetje religjioni i tyre, por është magjepsëse për të parë se çka janë shoqatat e ndryshme dhe grupet qytetare për ta bërë një gjë. Në Mançester ekziston muzeu, në të cilin mund të shihet ekspozita e artistëve të Kosovës, duke filluar nga Xhevdet Xhafa dhe të tjerët. Dhe ato shoqata qytetare në Muzej, të cilin e quajnë Qendra Memoriale, e kanë organizuar një program që është i dedikuar fëmijëve nga Podujeva, lidhur me atë se si fëmijët e panë atë që ndodhi dhe pastaj se kohën e tyre për themelimin e të vërtetës dhe drejtësisë. Fëmijët janë shpërblyer me çmimin „Ana Frank” është një nga çmimet që janë dhënë për kurajën dhe vendosmërinë e fëmijëve. Pse këta fëmijët marrin këtë çmimi? Në vitin 2002 në Beograd filloi një gjykim i pjesëtarëve të "Shkorpionit" për vrasjen e nënës së tyre, motrave dhe vëllezërve, çka do të thotë ka ndodhur tri vjet pas ngjarjeve. E gjithë kjo ishte ende e freskët, është kështu, për fëmijët e di se çfarë është 3 vjet, ata ëndërronin nënën e tyre për çdo natë. Ka qenë një Genc i vogël që zgjohej nga gjumi në mëngjes dhe kërkonte nga nëna për ti sjellë një gotë qumësht dhe ajo nuk ishte. Dhe askush nuk mund të shpjegojë atj se ajo nuk është më dhe nuk mund ti sjell qumësht. Ky gjykim ka filluar dhe padia ishte e keqe për shkak se prokuroria nuk arriti të vije deri tek emrat e viktimave, as për ata të cilët janë vrarë por as për fëmijët e mbijetuar. Fondi për të Drejtën Humanitare i mblodhi të gjitha informatat dhe pastaj ka filluar komunikata e jonë më babain e tyre, sepse ka dy baba, që ata të vijnë në Beograd për të dëshmuar para gjykatës. Unë dhe sot mendoj se babai Selatin Bugujevci vërtet meriton një çmim të madh për shkak se ai kishte kuptuar se është mirë për fëmijë që ata të luftojnë për të vërtetën për atë që ndodhi nënave të tyre, motrave, dhe është mirë se ata të flasin në mes të Beogradit, nga ka ardhur policia në Podujevë dhe e bëri këtë krim të tmerrshëm. Kjo që fëmijët vijnë në Beograd dhe nën përcjelljen e policisë serbe, të flasin para gjykatës në lidhje me këtë incident kjo ka ndodhur në vitin 2003, vjet përsëri në dhjetor filloi procedura kundër katër pjesëtar të tjerët të "Shkorpion" dhe ata prapë erdhën për të dëshmuar. Ky udhëtimi i tyre, kjo lufta e tyre e tyre me vite të tëra e gjatë për tu dëgjuar e vërteta dhe bindja e tyre, ata këtë e kanë mësuar në Mançester duke shikuar Qendrën përkujtimore, duke dëgjuar viktimat e Holokaustit, se sa në fakt është e rëndësishme që të flitet në opinion në lidhje me atë që ndodhi, si ndodhi dhe nuk ka më të mirë dëshmitarë se fëmijët e që përgjigjen jo vetëm në lidhje me vrasjen dhe pushkatimin e afërme të tyre. Ata kanë parë si u përzunë njerëzit nga shtëpia. Kjo është arsyeja pse u dënuan gjeneralët e ushtrisë dhe policisë së Republikës së Serbisë. Ata kanë shikuar si zbatohet në praktikë, depërtimi i njerëzve, si dëbohen njerëzit, si mijëra e mijëra vrapojnë në pyje dhe pastaj forcat policore i përzunë dhe ata duheshin të shkonin në vendin e tretë, që të shkojnë në Shqipëri. Eh, në Podujevë e gjithë historia, lufta e tyre për të vërtetën, lufta për drejtësi është reguar. Dhe ata mësuat se është shumë e rëndësishme, është një kujtim publik. Atë çka ata

ndjejnë si fëmijë, dhembja për nënën e tyre, motrave të tyre, që ajo ndjenjë duhet të shfaqet dhe para të tjerëve, për të kuptuar dhe tjerët dhe se ata duhet lirë dhe hapur të flasin se ata kanë nevojë për mbështetje që ata kanë nevojë për dhembshuri dhe jo vetëm nga pala shqiptare, por se ata kanë nevojë për dhembshuri dhe nga ana tjetër që në fakt i takon anës armiqësore. Fëmijët kanë qenë në gjendje për të mësuar këtë. Fëmijët këtë e kanë treguar dhe dy ditë në Podujevë më 28 dhe 29 ku ishte përkujtimi i së kaluarës më i mirë të cilin unë kurrë nuk e pashë në jetën time, por një pjesë e përkujtimit të së kaluarës ishte oda e guximit të fëmijës dhe oda e jetës. Kjo është ajo, për të thënë, protestante, angleze, në fakt, religjioni jetësor i tyre në të cilin ata u rritën, që kujtimi, kujtesa, asgjë nuk duhet të harrohet, të gjitha duhet të mbeten publike, të shkruar, të organizuara dhe të ruhen me kujdes, por se nuk duhet të ketë urrejtje, por të tjera duhet të mësojnë sa dhe si duhet të bëhen përpjekje për të krijuar një të vërtetë dhe se është e rëndësishme kur ju e themeloni një të vërtetë që ajo të shprehet publikisht. Fëmijët kanë bërë , unë nuk e di, ndoshta ka marr pjesë 2 deri 3 mijë vetë për ta bërë "hartën e paqes". Kjo "hartë e paqes" është në murrë të shkollës fillore në Podujevë e cila është e madhe 25 metra me 25 metra dhe është diçka më e mirë që unë pashë. Ato janë mesazhet në gjuhë të ndryshme. Ato janë mesazhet që janë të shkruara dhe paraqitur nga artistët por atje janë dhe mesazhet të zakonshëm, si që e shkrova unë : " Më drejtësi deri tek paqja", por me duket disi, të them, si një përkujtimore. Për mua nuk ka memorial më të bukur sesa një "Hartë e paqes.", ne gjithashtu, unë gjithashtu e quaj Memorial - ekspozitën në shkollën fillore që ishte krijuar dhe e ka emrin " Ruajmë kujtesën." Pra, e gjitha ishte e përkushtuar ndaj kujtesës, diçka fantastike. Të gjithë fëmijët e Bugujevcit, ata studiojnë fakultete të ndryshme të artit, të fotos, për regjisor. Dhe pastaj Fatosi, për të cilin mendoj se e studion foton, ai i kishte bërë një foto në mur ku ishin anëtarët të familjes së tij që u vranë, dhe anëtarët e familjes me të cilët ai jeton. Dhe kështu, unë që jam laik për fotot, por mendoj se kam parë në fotot shikim e tyre që ishte ndryshe. Unë pastaj i lexova emrat dhe e dija se cili nuk është më gjallë, por unë pastaj pash se portreti i tyre ishte deri në gjysmë. Pastaj afër këtyre fotografive ishin ata në të cilat ishte dhe vete Fatosi dhe te tjerët të cilët kanë qenë të kthyer nga ata të vdekurit. Dhe për mua kjo ishte diçka e tmerrshme, shumë e trishtueshme. Sa ka aty ndjenja, sa ka kujdes, si për të, nuk e di, një dizajn mjaft i fortë me kujtesë dhe kujtime të cilat duhen të bëhen në opinion ... Ose tjetra Jehona . Aty ishte një murrë të cilin ajo e ka rregulluar, dhe aty janë fotot. Të gjithë janë shumë të bukura, ka shumë gra të bukura dhe si pas veshjes shihet që janë fotot para 30 apo 40 vite, pastaj disa nga fotot me rroba që tani vishen dhe të gjitha në korniza të vjetra hyjnore. Aty në afërsi ishte një grua shumë e bukur, e cila ishte veshur në rroba stilit të viteve të 60, por ajo nuk ishte një grua e thjeshtë, por me shumë stilit, e cila ishte kujdesur për atë se çka do të vesh dhe si do të duket. Dhe unë pasi kam ditur se si duket u ktheva dhe e pyeta se a është kjo nëna jote. E ajo më tha: Po. Dhe tani çfarë është thelbi i kësaj, në gjykim duke dhënë deklaratën, duke folur për nënën, imagjinoni situatën, kjo do të thotë se nuk ka lidhje me faktet ... Ajo thotë: nëna ime ishte shumë, shumë e bukur ! Dhe këta që ishin të gjithë në sallë qëndruan te habitur. As gjykatësi nuk mund të vënë në pyetje të gjithë heshtnin , heshtnin mezi gjyqtarja i nxiti disa nga faktet dhe në krye të saj është gdhendur dhe në murrë shkruante bash kjo. Shkruante : "nëna ime është shumë e bukur." Jo nëna ime ishte shumë e bukur, por aty shkruante "nëna ime është shumë e bukur." Dhe që do të thotë se diçka mbetet, e cila mbetet përgjithmonë, por është shumë e rëndësishme për tu parë. Shumë po më dhimbeni si nuk keni pasur mundësi ta shihni, se siç kam dëgjuar ekspozita zgjati 3 ditë: të premten, të shtunën dhe të dielën dhe shumë pak zgjati. E kanë parë vetëm njerëzit në Podujevë. Dhe kjo është një mëkat i madh.

Por një tjetër gjë e bukur që pashë, që këto dy ditë në Podujevë është jetuar në një mënyrë krejt ndryshe. E dini se si të gjithë ne, nëse ajo është në Kosovë, nëse është në Kroaci, Bosnje, si duken përkujtimet të kaluarës. Duken shumë të pikëlluara, mbajnë fjalime, dhe shpesh herë fjalime politike, nuk përmendën emrat e viktimave. Nuk ka. Disi flitet për një kolektiv! Por këtu në Podujevë emrat e viktimave ishin shumë të rëndësishme dhe pastaj 2 ditë zgjati programi i cili ishte përkushtuar fëmijëve, jetës, kujtimeve dhe themelimin e një kulture të kujtesës. Nga Anglia, nga Mançesteri kishte ardhur një bend cili dy ditë radhas ka mbajtur koncert në Podujevë. Të gjithë fëmijët e Podujevës ndiqnin bendin. Grupi nga Mançesteri, bëri një park të paqes në Podujevë. Parku ishte, kemi kaluar 2-3 orë në park, ka pasur njerëz të ndryshëm ti cilët kan mbajtur fjalime imagjinoni, mjekun britanik i cili erdhi në Kosovë në qershor 1999. dhe operoi një numër i madh të njerëzve të plagosur. Ai i ka operuar dhe këta fëmijë, dhe pastaj i ka marr me vete dhe i solli në Angli. Sot aj mjek është në Afganistan. Dhe paramendoni atë mjek duke folur për drejtësinë në tranzicionon. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të krijohet drejtësia pas luftës. Dhe atëherë unë kam kuptuar kush janë më të vërtetë mësuesit e këtyre fëmijëve. Qe ky kirurg, imagjinoni flet rreth drejtësisë tranzicionale. Pastaj aty është dhe një punonjëse sociale, e cila gjithashtu flet për drejtësinë në tranzicion. Në park ishte një numri i madh i qytetarëve nga Podujeva, dëgjohet, përkthimet janë konsektiv, fëmijët dëgjojnë. Ky manifestim me të vërtetë dukej si diçka e pamundur në përgjithësi kudo në Ballkan të organizohet diçka e tillë. Dhe Fjollën kur e pyeta se a është diçka transferuar në televizion, asgjë nga kjo nuk ishte. Pra, mbetet për tu kujtuar, dhe mos të harruar nga ata që kanë qenë për të parë, të cilët morën pjesë në të, dhe unë gjithmonë kanë nevojë për të folur për atë çka unë pashë për këto dy ditë dhe sepse aj manifestim ishte duket aq i bukur. Unë kam parë në fytyrat e fëmijëve nga Bogujevci se ata ishin të lumtur sepse pothuajse e gjithë Podujeva ka ardhur për të marrë pjesë në festimin e përkujtimit dhe jo vetëm për këtë krim të tmerrshëm, por duke shënuar këtë si një mbështetje ndaj familjarëve. Edhe diçka, më falni, ta përmendi edhe diçka që ishte në atë program. Ka qenë para shumë kohe, a mund ta imagjinoni. Është një fshat që quhet Lupq i Ulët. Mësuesja nga Lupq i Ulët me fëmijët bëri një pikë baleti dhe si duket edhe koreografinë, ajo dukej fantastike me fëmijët nga 3-4 vjeç deri tek 7-8 vjeç në fund të pikës ata u renditen ashtu bukur të veshur, dhe në teshat e tyre, teshat e balerinave a e dini, çfarë shkruante „Thank you Mançester. Kjo ishte dukur për bukuri dhe tash mund ta shihni se këto komemorimet e përkujtimeve mund të kenë një formë tjetër dhe se sa e rëndësishme është kjo, në fakt, roli, rolin e artistëve në memorializim. Isha e detyruar të ju them këtë sepse në Podujevë nuk do të ishte e gjithë kjo mos do të ishin artistët, mos të kishin marr pjesë piktorët, mos të kishin marr pjesë dramaturgët, regjisorët. Por për ata është një çështje personale e angazhimit anglez për t'u treguar atyre viktimave, për të demonstruar atyre që ajo çka ka ju ka ndodhur është e rëndësishme edhe për se viktimat janë të rëndësishme. Kjo është ajo që neve na mungon në këto treva, viktimat përmenden kur ne duam të themi se të tjerët janë të këqij, që kanë kryer krime por pas saj nuk ka asnjë lloj marrëdhënie ndaj viktimave. Ne me këtë iniciativë duam të përpiqemi, ne nuk mund të bëjmë atë që bëri Mançesteri, nuk kemi atë kulturë, nuk e kemi atë religjion. Ne nuk kemi të ndërtuar kulturën e angazhimit qytetar në këtë mënyrë, por mund mundohemi sepse kemi artistë të cilët vërtetë e dinë se sa është e rëndësishme për tu krijuar faktet, se sa i rëndësishme është fakti kur kundërvihet mohimit, refuzimit. Dhe tek ne ende, në disa shoqëri, ekziston kultura e mohimit total se diçka ka ndodhur në

shoqëritë tjera, ka një kulturë të plotë makthi, se vetëm ata janë viktimë dhe se nuk ka asgjë përtej asaj. Kemi nevojë që të kaluarën ta shohim së bashku, për të parë në bazë të fakteve, dhe të kuptojnë se ne nuk mund të bëjmë një ditë nuk ekziston, sikur ne nuk kemi më lidhje me të kaluarën, sikur të rinjtë e brezit të tanishëm dhe të ardhshëm, për shkak se nuk kanë përgjegjësi për atë që ndodhi, ata nuk kanë përgjegjësi për qëndrimin ndaj të kaluarës. Ekziston kjo përgjegjësi e pavarur ndaj neve, por gjëja që ne duhet ta bëjmë është menjëherë, në fakt, vetëm të mendojnë për mënyrën se si ne do të ndërtojmë këtë përgjegjësi në të kaluarën për shkak të faktit se ne kemi gjithkrah elita politike që janë të interesuar për pushtet, mbajtjen e pushtetit dhe nuk e shohin se e kaluara është një mjet i rëndësishëm për të mbajtur pushtetin e tyre. Tani ka një të ardhme, ka disa vizione të tjera, dhe nuk është më e kaluara, krimet e mijëra e mijëra viktimave, atë forcë të cilën e ka pasur disa vite më herët. E jona është, mendoj në organizatat për të drejtat e njeriut, mendoj në organizatat jo-qeveritare që tani duhet të arrijmë të bëjmë këto konsultime, këtë debat rajonal, për të marrë pjesë një numër i madh i njerëzve në këtë debat që thjesht nuk të lejojnë që pyetjet në lidhje me të kaluarën, në pyetjet e fakteve se çfarë ndodhi, si ndodhi, pse ndodhi, që mos të lejojmë që të zhduken. Është detyrimi ynë dhe ne jemi të vetëdijshëm për detyrimet që rrjedhin prej mandatit të organizatës për të drejtat e njeriut dhe ne këtë çështje duhet të mbajmë në mënyrë të vendosur si një nga çështjet më të rëndësishme në lidhje me të ardhmen dhe detyrimet për krijimin e kujtesës historike të cilat do të bazohen në fakte. Unë ju ftoj të bashkoheni me të, të mendojmë se si të veprojmë se ne kemi një qëndrim përgjegjës ndaj të kaluarës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ne dhe për të organizatës për të drejtat e njeriut. Është e rëndësishme për të gjithë njerëzit. Kjo është e vetmja mënyrë, ne të cilët nuk kemi ndonjë viktimë direkte të tregojmë se sa të rëndësishme janë viktimat për ne dhe të përpiqemi për atë çfarë ekziston tani, armiqësia, unë nuk mendoj se ne tani duhet ne të falim. Asgjë nuk mund të harrohet. Nuk duhet harruar. Në kuadër të mandatit tonë është krijimi, ndërtimi kulturor i kujtesës, që mos të harrohet. Jo dhe ne nuk përfaqësojnë asnjë pajtim, kurrfarë falje. E gjithë kjo po ndodh në nivel individual ose nuk është duke ndodhur. Ne duam që të ruajmë, ruajmë njohurinë. Për të bërë publike njohurinë se çka ka ndodhur të kundërvihemi mohimit, për të treguar se viktimat janë të rëndësishme dhe për të mos lejuar që kjo të ndodhë përsëri në këto treva, siç ka ndodhur këtu çdo 50 vite. Më falni se nuk pata mundësi pa e përmendur Podujevën sepse kjo ishte më datën 28 Mars, por unë gjithmonë mendoj për ato dy ditë të pabesueshme dhe se unë e kisha atë privilegj ta shoh dhe u përpoqa t'u përcjelli se si dukej ai manifestim dhe si ishte e pa mundur gjithë ai manifestim për rajonin e Ballkanit. Kaq për tani!

Sarah Maliqi:! Faleminderit Natasha. Shukrija e ka kërkuar fjalën!

Shukrija Gashi: Të nderuar pjesëmarrës, fjala e zonjës Kandiq, më preku shumë, sidomos në lidhje me ngjarjen në Podujevë dhe unë i kam hedhur në letër disa vargje, të cilat dëshiroj t'ua lexoj.

Viktima

Më dhemb heshtja shekull

Dua të pëlças o njerëz

Ju nuk i njihni ofshamat

Ju nuk i njihni ofshamat e mija
Çdo mbrëmje dhe mëngjes

Flini të qetë pa sy
Dhe nuk keni as vesh

Unë jam dhembje pa emër
Harruan në heshtje shekull
Që ndodhi vetëm dje

Më pagëzoni, ju lutem
Nuk dua të vdes
Nuk dua të vdes pa emër

Faleminderit,
Nëse më dëgjoni ndonjëherë

Sarah Maliqi: Faleminderit Shuki! Edhe unë gjithë prekem për atë që flet Natasha. Tash ia japim fjalën zotëriut Haris Pashoviq. Unë edhe desha, nëse më lejohet, shkurtimisht ta prezantoj. Sot me ne ka ardhë, ka udhëtuar shumë gjatë. Ka ardhur mbrëmë shumë vonë, domethënë në 1,30 të mëngjesit dhe shkon sot menjëherë në ora 16, niset për aeroport dhe e falënderoj shumë që ka ndarë kohë të vjen. Haris Pashoviq, është një ndër regjisorët e teatrit më të shquar në Evropën Juglindore. Është drejtor artistik i ... kompani në Sarajevë. Gjatë rrethimit të Sarajevës shumicën e kohës ka qenë aty por shumicën e kohës është marrë me menaxhimin e festivalit ndërkombëtar të teatrit MES. Më 2005 e ka themeluar Kompaninë East-West ... kompani dhe po ashtu është bashkëthemelues i Departamentit të regjisë së arteve performuese në Sarajevë si dhe profesor në këtë akademi si dhe në shkollën e menaxhmentit në Bled të Sllovenisë. Është autor i një numri të madh të shfaqjeve të dokumentarëve dhe shumë shkurtimisht po ia jap fjalën tani. Faleminderit!

Haris Pashoviq: Faleminderit shumë Sarah! Natasha e ka përmendur në një vend duke folur për Podujevën, njerëzit janë duke i shikuar ata të cilët nuk kanë shikim. Ndërsa Shukrija e ka shkruar një këngë për njerëz të cilët në artistët dhimbje nuk kanë emra. Dhe unë mendoj se ky është vend ku ne takohemi artistët dhe luftëtarët për të drejtat e njeriut, sepse kemi një qëllim të përbashkët dhe përgjegjësi të përbashkët, ajo është e vërteta. Dhe është vizion si të jetojmë me të vërtetën. Herbert Zhbignjev është poet nga Polonia i cili në vitin 1982, ka shkruar këngën e cila quhet "Raporti nga qytetit i rrethuar". Unë këtë këngë e kam ditur por prapë e kam ri-zbuluar në Sarajevë gjatë rrethimit dhe në fund të këngës ai thotë "varrezat rriten, zvogëlohet numri i mbrojtësve, por nëse qëndron vetëm një, ai do të jetë qytet, ai do ta dërgoj qytetin në rrugë të dëbimit. Dhe kështu, nëse ne të gjithë këtu heqim dorë, dhe nëse qëndron vetëm një, nëse qëndron vetëm Natasha ajo do të jetë një masë e të vërtetës. Ajo do të jetë një masë e realitetin. I dyti, një shkrimtar i madh Amin Maluf, shkrimtarin francez, supozoj se shumica nga ju e ka lexuar librin e "Samarkan" ai tha në një intervistë: "Unë jam gjithmonë me ata që janë pakicë." Unë mendoj se në këtë vend, ne takohemi, jemi luftëtarë komplementarë për të drejtat e njeriut dhe artistë dhe ne e kemi një obligim. Është detyrë, por kjo detyrë, është si në sanskret, si fjala "darma" që është bazë e Hinduizmit dhe Budizmit. Kjo detyrë është detyrë e botës. Kjo është një detyrë që ne nuk mund të injorojmë në qoftë se

duam të jemi artist dhe në qoftë se duam të jemi njerëz. Natasha më ka lutur të them diçka në lidhje me atë që ne kemi bërë gjatë vitit 2006, por të më lejoj të shkoj pak më tej në histori dhe pastaj do të vijë tek viti 2006. Unë jam këtu për herë të parë dhe do të flas për këtë temë të rëndësishme - krijimin e fakteve dhe të tjera. Eja të gjejmë së bashku, si të jetojmë në të tanishmen dhe në të ardhmen, e të mendojmë për të kaluarën. Duhet të them, kur unë isha ndoshta 6 ose 7 vjet, mendova, jam rritur në Sarajevë dhe mendova se fjala "Shiptar" do të thotë bartës. Sepse, kur është thënë diçka e tillë, dikush që hyjnë në shtëpi të re, apo për të ndihmuar në ndonjë mënyrë thoshin që duhet thirrur "Shiptarin". Këta ishin njerëzve të cilët, për mua si djaloshin, kanë qenë të uniformuar. Ato kishin të bardhë në kokë, në atë kohë i kemi quajtur çullah, i kishin trakët e forta, me të cilat i bartnin disa gjëra, u mblihdeshin në një vend që është në treg, në qendër të Sarajevës, dhe në qoftë se dikujt i duhet diçka, kryesisht ishin njerëz të moshuar, dhe në qoftë se dikush kishte diçka për të ndihmuar pastaj ata kanë shkuar, ju mund ti angazhoni, i paguani, dhe ata do të vijnë. Në heshtje e kryen punën e tyre. Ata kanë qenë shumë të fortë, të ndershëm, efikas në punën e tyre. Shumë vjet më vonë, unë do të kuptojnë se ajo që mendova se fjala "Shiptars" do të thotë bartës, flet për thellësinë e aparteidit, aparteidi jugosllav, në të cilën jetonin shqiptarët e Kosovës. Disa vjet më vonë, në klasën time në shkollën fillore erdhi një vajzë, e cila quhet Suada Axhanela. Unë jam dashuruar në atë. Dhe ne patëm diçka, ajo ishte një lidhje fëmijërore. Pastaj kam marr vesh se ajo është duke punuar në një radio. Ky radio ishte programi në gjuhën shqipe në Radio Sarajevë. Unë pastaj fillova të kuptoj se në fakt ka njerëz që jetojnë në Sarajevë, të cilët flasin një gjuhë tjetër si gjuhën e tyre, se kanë radio në programin e tyre, dhe pastaj flisnim pak për programin në të cilin ajo punonte, unë në fakt fillova të kuptoj diversitetin aktual në atë mënyrë. Në Sarajevë kanë jetuar dhe serbët dhe kroatët dhe myslimanët dhe njerëzit nga martesat e përziera, ajo ishte një rrezik, megjithatë, për shkak të diferencës e cila ka qenë relative ,ka praktika të tilla, si dikush një Bajram, dhe një Pashkë dhe se kjo-ajo, por ashtu do të thotë se ishte një kulturë. Kjo ishte hera e parë që kam kuptuar, si një djalosh çfarë do të thotë që dikush në vendin tim - Jugosllavi flet një gjuhë të ndryshe nga e cila unë kuptoj. Pastaj, në shkollë të mesme unë fillova të shkoj në teatër. Në familjen time, kjo nuk është një traditë e madhe për të shkuar në teatër, nuk kanë qenë njerëz vizitorë të pasionuar për teatër, por unë e kam zbuluar pasi shkova, dhe pastaj dëgjova për Fadil Hysaj i cili në atë kohë ka studiuar në Sarajevë, i pashë disa nga shfaqjet e tij dhe pastaj dëgjova për Istref Begolin, dhe pastaj Farukun dhe kështu me radhë dhe tani unë kam filluar ta formoj një foto më komplekse për shqiptarët e Kosovës, për Kosovën. Dhe pastaj, mendoj se isha i regjistruar në akademinë, ose mund të mos kam qenë, kështu që ishte atëherë, dhe do të kujtohem në lidhje me ngjarjet e periudhës së viteve 80 ose 81. Kam shkuar në festivalin MES, ai ishte një nga festivalet më të madha të Jugosllavisë dhe ishte e mrekullueshme për të parë të gjitha shfaqjet cilat kanë ardhur nga Beogradi, Zagrebi, Lubjanë, Shkup dhe kudo. Dhe një herë ishte në program një shfaqje nga Prishtina. Kjo ishte për mua shumë interesante për të parë se si duken tani shfaqjet në Prishtinë sepse kanë luajtur në shfaqje aktorë të mrekullueshëm si Istref Begolli, Melihate Ajeti. E gjitha ka qenë e mirë, në fakt, më kujtohet ajo shfaqje, por nuk më kujtohet titulli. Unë erdha në Teatrin Kombëtar në Sarajevë, në qoftë se dikush nuk ka qenë, kjo është një ndërtesë shumë e madhe në stilin barok me ballkone të dekoruara shumë bukur. Unë arrita në shfaqje dhe pashë se nuk ishte diçka në rregull ishte diçka shumë e çuditshme. Ishte në teatër një audiencën tjetër, nuk ishte audienca që vinte në shfaqjet e tjera. Ata ishin njerëz që janë veshur shumë mirë por shpesh nuk vijnë në teatër. Performanca ishte në gjuhën shqipe dhe përfundoi në mënyrë që, pastaj

unë kam kuptuar se në fakt shumica e audiencës është e përbërë nga shqiptarët që kanë jetuar në Sarajevë. Unë në fund të kësaj shfaqje, një djalit, Istref Begollit i cili e ka luajtur gjyshin e tij, ja jep armë në dorë. Unë kam qenë kështu, mendoj se diçka nuk ishte mjaft e mirë performanca sinqerisht ju them. Ishte pak sa e vjetër, ishte një mënyrë pak romantike, ishte në një mënyrë të, nuk ishte mjaft emocionuese si ngjarjet në teatër. Pastaj nisen diskutimet pas çdo performance ditën tjetër në tryezën e rrumbullakët ku gjendeshin kritikët nga e gjithë Jugosllavia, të cilët më pas kritikonin në lidhje me shfaqjet. Të nesërmen u ngrit një kritik nga Beogradi dhe tha se kjo ishte një shfaqje nacionaliste, një shfaqje iridentiste, dhe unë nuk e dija se çfarë do të thotë fjala iridentiste dhe që ka qenë shumë e tmerrshme që ajo u shfaq në festival dhe kështu me radhë. Dhe mua më dukej e çuditshme. Atëherë fillova të kuptojë se ka një problem këtu. Unë nuk e kam ditur se ka një problem në përgjithësi. Dhe pastaj të nesërmen, i njëjti kritik, çohet dhe e merr kështu "Politikën" dhe titullin në faqen e parë dhe thotë: E shihni se çka ju kam thënë? Në faqen e parë të " Politikës" ishte një raport në lidhje me protestën e studentëve në kantinë këtu në Prishtinë, kur studentët filluan të derdhnin supën nga pjatat në shenjë protestimi. Më pastaj ishte shumë interesante. Në fakt, unë shumë, i liked it. Për mua ishte shumë interesante. Më ka pëlqyer kjo. Për mua kanë qenë mjaft teatrale, rrotullimet dhe konfliktet. Unë e paramendoja, ju e dini kantina e madhe, përplot me student,ata të gjithë vijnë dhe derdhnin supën. Është një performancë e madhe. Pas kësaj, natyrisht, unë fillova pak më shumë të kuptoj në atë kohë isha në fakultet në Novi Sad, kuptova tani se ka disa probleme pak më komplekse dhe unë isha i gatshëm për ti kuptuar, por jo plotësisht. Pastaj kam qenë në Beograd, atje ishte Enver Petrovci dhe pak si jemi shoqëruar, jo shumë, por edhe kohë pas kohe. Pastaj kam qenë në ushtri në Knjaževac, aty ishte një mjek nga Prishtina, Jusufi i cili më ka folur pakëz më shumë dhe po ashtu ka pasur edhe disa oficerë që ishin shqiptarë të cilët ishin shkarkuar ose degraduar sepse ishin futur në disa probleme, flitej se ata ishin të përfshirë në armë, apo diçka ngjashme ... Gjithmonë ishte diçka, a e kuptoni, por nuk ishte e përqendruar dhe kështu me radhë. Dhe atëherë në televizion në Sarajevë 1989 e pashë në Kosovë, fjalimin e Millosheviqit dhe atyre miliona njerëz dhe përsëri nuk e kishin plotësisht të qartë, unë mendoj se unë isha disi larg nga gjërat e dukshme, por e kisha një ndjenjë jo të këndshme, ishte shumë e çuditshme që kaq shumë njerëz janë mbledhur e ai me stil të lartë, teatral nëse ju kujtohet ai erdhi me helikopter doli si pjesë ... makina, dhe pastaj doli dhe i renditi të gjithë presidentët, dhe Dërnovshekun dhe të gjithë që kanë qenë në radhë të parë dhe më pas ju mbajti një leksion, dhe atëherë tha, për herë të parë, për një politikan në ish Jugosllavi në fjalimin e tij zyrtar e ka përdorur fjalën armë, për shkak se tha, në qoftë se duhet serbët do të jenë të gatshëm për tu mbrojtur me armë. Kjo është një histori e shkurtër e mia për mosdije në lidhje me Kosovën, dhe pastaj shumë shpejt dhe filloi lufta në Bosnje, së pari në Kroaci dhe pastaj në Bosnje. Unë nuk kam qenë në momentin që filloi rrethimi i Sarajevës në Sarajevë. Pas një përpjekje të gjatë dhe të komplikuar, kam arritur të vijë në Sarajevë pas disa muajve. Sepse, ndër të tjera, më ka udhëhequr ajo që idhujt e mi në jetë janë Ernest Hemingveji, Ana Ahmatova, Xhorxh Orvel. Pra, artistë të cilët kanë qenë të mëdhenjë të cilët në momente shumë të rëndësishme shkuan në vende që ishin shumë të rëndësishëm. Domethënë se Hemingveji dhe Orvel ishin në luftë civile në Spanjë dhe Ana Ahmatova kishte shkruar poezi gjatë rrethimit të Leningrad. Dhe kjo ishte një motiv intelektual dhe artistik të jetës në Sarajevë gjatë luftës. Natyrisht , unë kisha motive private dhe emocionale. Atje cilin ishte familja ime dhe nxënësit e mi, por unë duhet të kisha dhe arsytimin intelektual para vetës, pse unë duhet të veproj kështu. Dhe pastaj, kur filloi në vitin 1999 agresioni në Kosovë, unë pastaj regjistrova një film

dokumentar dhe shkova në Shqipëri në qendër të refugjatëve në Tiranë, në Elbasan dhe Kukës. Unë atëherë i kam ditur disa, sepse në mendjen time ishte e pranishme dhe fotografia e qendrës së refugjatëve sepse ka pasur shumë në të cilat ishin njerëzit nga Bosnja. Por sigurisht njëri nga më të trishtueshmit ishte në Kukës kur kjo ishte në fakt një skenë biblike e mërgimit, kur në livadh gjinden ndoshta më shumë se 100 000 vetë, një det i pafund njerëzish ulëshin nën tenda, në një gjendje shumë të vështirë dhe pa e përshkruar, gjendje shpirtërore dhe mendore. Unë kaloja afër këtyre tendave. Ndonjëherë, kur provoja të regjistroja ndonjë njëri e para ishte se gjuha tani ishte serbe ... dhe pastaj kur ju tregofsha se jam nga Sarajeva pastaj njerëzit ishin pak më të hapur dhe kemi bërë disa biseda, dhe e kemi regjistruar një dokumentar në atë kohë. E tash, tek tani në vitin 2009. me disa vite të mëparshme, kështu që nga viti 2006. në fakt, hera e parë që jemi ulur, kur ishin artistët nga Kosova në Beograd, së bashku me artistë nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Maqedonia, Mali i Zi, dhe kemi diskutuar se çfarë është detyra jonë në këtë kohë dhe se cili është rol i jonë. Unë mendoj se detyra jonë është të shkojmë atje ku të tjerët nuk mundën ose nuk guxojnë të shkojnë. Unë mendoj në një kuptim shpirtëror, ndonjëherë edhe fizik, a po. Ne duhet luftuar kundër asaj, a thuhet në anglisht Conventional Wisdom do të thotë mendim i përgjithshëm. Dhe në Bosnje bëhet fjalë për Sarajevën para se gjithash, ne vërtet kemi punuar prej ditës së parë të rrethimit nëse doni të dini. Unë mendoj se artistet e kanë pasur rolin shumë të madh në Sarajevë, pastaj Sarajeva si një qendër nga e cila është në të vërtetë rrezatimi, dhe fillon të shkojë në vende të tjera në Bosnje dhe Hercegovinë, për të qenë dhe të mbetet multikulturë. Ne e kemi ditur se është vendimtare që Sarajeva të mbetet shumë kulturore. Që Sarajeva të jetë multikulturore me çmimi dhe nëse në Sarajevë, nuk do të jetoj askush tjetër që nuk është Boshnjak. Edhe atëherë duhej të jetë multikulturore. Sepse multikulturalizmi është gjendje e vetëdijes e jo gjendje e demografisë. Mbjaj mend, në atë kohë gjeneralëve që e udhëhoqi mbrojtjen e Sarajevës ju thash. Në Sarajevë mund të mbeten vetëm myslimanët por unë nuk do të jem kur fashist. Pra, artistë në Sarajevë këtë shumë mirë e kanë kuptuar dhe shumë mirë janë përkujdesur për multikulturalizmin, kozmopolitizmin si një bazë të përgjithshme, për ne të mund të jetojmë dhe të marrim frymë në një botë që është i denjë për të jetuar në të dhe jo si Marina Cvetajeva të shkojmë dhe të shkruajmë – të themi, Refuzuar të ekzistojnë, nuk dua ditët ti numëroj në shesh në mesin e ujqve. Mbetet ose të refuzojmë të ekzistojmë, mos të jetohej në mesin e ujqve mos të jetë ... sepse ne e kemi në gjuhen boshnjake, kroate, dhe serbe dhe në gjuhen malazeze fjalën, e cila në fakt është shumë e vështirë për ty përkthyer në gjuhë të tjera, ndoshta mund të përkthehet shqip, fjala është "vukojebina. Ky është një vend ku nuk ku me shkua më se kaq. Nëse nuk dëshirojmë të jetojmë në „vukojebinama " artistët duhet të bëjnë një vend i cili do të jetë i denjë për të jetuar. Ne jemi domethënë në mes të rrethimit. Natyrisht, ishte një klimë, ju e dini. Në Sarajevë, gjatë rrethimit të katër vjetor, të cilin e kanë mbajtur ushtarët serbë të Bosnjës dhe ushtarët të Ushtrisë Kombëtare Jugosllave dhe forcat paramilitare ushtrisë serbe. Nuk është dëmtuar asnjë kishë nga brenda. Pra, nëse një kishë ortodokse është e dëmtuar është dëmtuar nga ata që e kanë bombarduar, siç i kishin bombarduar të gjitha. Por askush nga Sarajeva, këtë nuk e ka bërë. Pra, ne e kemi pastër qartë se në qoftë se ne duam të kemi në kuptimin e përgjithshëm, në mënyra të ndryshme, që ne këtë civilizim, vlerën e civilizimit duhet ta mbajmë të gjallë. Dhe mendoj se kemi pasur shumë sukses. Unë sot e kam një teatër të pavarur, i cili quhet " East Weast Qendra" ose „East Weast Company " dhe jemi shumë të suksesshëm në planin ndërkombëtar. Ne luajmë shfaqje në festival në Edinburg, në Singapor, në Rumani, dhe Sant Petersburg, tani do të shkojmë në Poloni. Por çdo herë kur vijmë nga festivali ne shkojmë me shfaqje në një

qytet të vogël në Bosnje. Ne kemi luajtur në më shumë se 25 qytete të vogla në Bosnje, ku pjesët teatrale kurrë nuk do të vinin. Pastaj ne arrijmë diku, ata thonë, nuk e di në Jablanicë, thonë se ky është kulturor më e madhe, mendoj tragjikomikët thonë se është ngjarja më e madhe kulturore në njëqind vitet e fundit.. Unë them jo, ju e keni pasur këtë " rrëzimin e urës," 43, a po, porti për të plagosurit,dhe kështu radhas. Dhe kështu ndonjëherë bëjmë shaka me ata. I vetmi konkurrent i madh në këtë rrugë nëpër Bosnje është cirku me një majmun dhe një gjarpër, i cili shfaqet në të njëjtin vend ku shfaqemi dhe ne. Atëherë ne jemi miqësuar me ta dhe shkëmbejmë disa kontakte me drejtorët e shtëpive të kulturës, dhe kështu, nga pak punojmë. Kur shkojmë për të luajtur në Festivalin e Edinburgut, ku dirigjent është Valeri Gergiev ose nuk e di ndonjë artist tjetër i madh, artistët më të mëdhenjtë të botës, luajnë me ta e pastaj kur kthehemi me kolegun tonë i cili udhëheq cirkun me majmunin dhe gjarpurin shkëmbejmë kontaktet dhe shkojmë në ato vende. Shkoj dhe në Republika Srpska. Ne e kemi një shfaqje që quhet "armik i klasave" është një shfaqje britanike me lejen e autorit Naixel Viliams e kam adaptuar sikur ngjarja të ndodh në Bosnje. Kjo ndodh në një klasë në Sarajevë dhe në një vend, një djalë ... ata janë shumë të dhunshëm, ju i dini problemet me të rinjtë, unë nuk e di se si ishte kjo, por mendoj se në Bosnjë, në Serbi, në Kroaci janë probleme të mëdha me të rinjtë në shkollat e mesme. Dhe pastaj një djalë thotë në një vend për të gjitha janë fajtorë serbët. Dhe ai ka një monolog racist rreth asaj përse serbët janë fajtorë për të gjitha dhe për atë që janë divorcuar babai dhe nëna, dhe për plehurat në rrugë, dhe përse autobusët vonohen, dhe për të gjitha këto janë fajtorë serbët. Ne me këtë shfaqje shkuam në Banja Llukë, në Prijedorë. Ky ishte teatri i pari nga Federata, gjë që do të thotë se ishte në Republikën Serpska në Prijedor dhe e luajtëm shfaqjen. Gjatë shfaqjes dikush bërtiti.... Po, po, këta janë serbët që i përdhunuan nënën e juaja. Aktorët vazhduan të luajnin. Pra, më kuptoni. Tash deri sa jam unë këtu,aktorët e mi janë në udhëtim në Livno, në Tomislavgrad në Jajce. Atje në Livno njëqind njerëz shkuan në shfaqje, ata thanë se për shkak... sepse shahet në shfaqje nuk e di çka është ajo, tamam si që është në jetë, sepse një profesor tha, ne nuk duam. Në ndërtesë në cilat ne po luajnë shkruan shkrimi NDH. Por ky është vendi ynë. Mua nuk do të më urdhëroj drejtori i shtëpisë kulturës në të cilën shkruan NDH apo drejtoresha e shtëpisë kulturës. Nuk e di në Derwent, a do të luaj unë aty apo jo. Këtë do ta përcaktoj audiencia ime, atë do ta vendosi unë. Do ta përcakton jeta. Mua më kanë shkruar nga Banja Luka, pas shfaqjes e cila ka qenë e pranuar shkëlqyeshëm. Ne e kishim sallën përplot me shikues. Njerëzit e kanë pranuar shumë mirë, kemi pasur mbështetje shumë të mira të mediave të pavarura. Dhe pastaj në një gazetë nacionaliste e cila quhej "zëri i serbëve " doli nga kolegu imi kritika, dhe ai është nënshkruar, cili thotë :, Është vështirë që Pashoviqi përsëri pas kësaj të vijë në Banja Llukë". Unë thashë mua nuk do të më urdhëroj „Zëri i Serbisë” se në cilat vende të shtetit tim unë do të shkojë. Pse e them këtë? Këtë e them për shkak se flas me emocion të madh, me kujdes të madh dhe me angazhim të madh, publik nëse doni, unë kam përcjell se çka është duke ndodhur në Kosovë viteve të fundit dhe kam qenë një përkrahës me zë të lart të intervenimit të NATO-s dhe e kam mbështetur Pavarësinë e Kosovës. Por unë mund të them që gjatë katër viteve të luftës në Sarajevë, unë kurrë nuk kam dëgjuar që dikush tha diçka në Kosovë për Sarajevën apo Bosnjën. Kur nuk kam, ndoshta ka qenë unë them vetëm se unë nuk kam dëgjuar. Unë nuk kam dëgjuar që një artist, një intelektual në Kosovë, tha se kjo nuk është e mirë, mos lejoni që Sarajeva të jetë e rrethuar. Unë sot, nuk e di mjaft se çfarë ka ndodhur në Kosovë nga ajo që artistët nga Kosova flasin. Unë nuk e di, unë nuk kam parë filma, unë kam parë shfaqje, nuk kam dëgjuar muzikë që ka artikuluar. Regjisoret tonë më së shumti kanë artikuluar traumat sociale. Dani

Stanović, Pierr ZHlatica, Srgjan Vuletic, Jasmina Španić, Aida Begic, Dino Mustafic dhe unë, dhe kolegët të tjerë tanë, në filmat dhe shfaqjet i kemi trajtuar çështjet kryesore në lidhje me shoqërinë tonë të sotëm, dhe për të zhdukur, dhe në Grbavic Jasmina Španić flet historinë e tregimit të një gruaje që e lindi fëmijën nga përdhunimi. Dani Stanović, flet për dy ushtarë armiqësor të cilët janë në të njëjtën gropë dhe ashtu me radhas mos t'u shpjegoj. Dhe për Bosnje kjo ishte shumë e rëndësishme. Për të gjithë ne ishte shumë e rëndësishme që në atë mënyrë të artikulohej traumat sociale. Në këtë kuptim, unë kam nevojë për më shumë kësi ndërtimi artikular artistik të vijë nga Kosova në skenën ndërkombëtare. Dhe një tjetër gjë! E di, unë mendoj se shqiptarët e Kosovës bash për atë shkak se para 30 apo 40 viteve, fëmijët kanë menduar se shqiptarë do të thotë hamall. Dhe bash për shkak të kësaj kanë ndodhur gjërat të tilla siç i përshkruante Natasha në Podujevës. Duhet të jenë kampion të drejtave të njeriut. Unë mendoj se shqiptarët e Kosovës duhet të jenë udhëheqës kur bëhet fjalë për të drejtat e njeriut. Ju më së miri e dini se çka do të thotë kur nuk ke drejtësi. Ju më së miri e dini se çfarë do të thotë për të humbur miqtë, familjen, lirinë. Neve në luftë na kanë ndihmuar shumë çifutët. Njerëzit të cilët ishin në Amerikë, në Evropë, në Izrael. Dhe atëherë unë ndonjëherë bisedoja me disa nga miqtë e mi që ishin më të vërtetë të angazhuar në çështjen e Bosnjës. Dhe ju kam thënë, unë e kuptoj atë por unë mund të supozoj por prap më tregoni përse ju aq shumë po angazhoheni. Ata më thanë, sepse ne mund të kemi ndjeshmërinë pak më të mirë, ndoshta jemi pakëz më shumë të ndjeshëm. Bash për atë se historitë tona familjare janë të shënuara në Holokaust. Pra, unë pres, si koleg, unë pres nga artistët kosovarë dhe intelektualët të Kosovës që të jenë të udhëheqës të këtij Komisioni, si që është Komisioni për përcaktimin e fakteve, ose në të gjitha planet tjera. Unë mendoj se është e papranueshme ajo çka ne dëgjojmë nëpër media që janë, pra, nuk janë propagandë, por nga media që ne mund t'u besojmë, nga mediat që kanë qenë shumë miqësore ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet e fundit, të dëgjojmë se si tmerrësisht shkelen drejtat e njeriut, kur janë në pyetje Serbët në Kosovë. Thjesht kjo nuk guxon të ndodh. Thjesht, ju pra jeni se pari ë artistët dhe luftëtarë për të drejtat e njeriut. Për atë unë them se në shkojmë ku të tjerët nuk shkojnë. Pra, ju jeni ata që duhet të flisni në emër të çdo njeriu, dhe të shqiptarëve dhe serbëve, dhe boshnjakëve, dhe kush do tjetër që jeton në këtë vend, që ne të gjithë se bashku mund të marrim frymë. Dhe shqiptarët në këtë moment nuk janë kampionët e të drejtave të njeriut. Dhe kjo është diçka që artistet munden shumë rëndësishëm ta lëvizin, kur është fjala për këtë çështje në Kosovë. Pra, ju keni të drejtë, dhe e keni për detyrë të kërkonin nga shoqëria në Kosovë, pa marrë parasysh në qoftë së shoqëri apo mbi dominojnë me shqiptarë apo në hapësirat ku dominojnë kryesisht serbët, të respektohen drejtat e njeriut dhe se ne të gjithë të mësojnë nga ju një mënyrë se si dhe ne në mjedisin tonë ta bëjmë atë. Të jetë një shembull për Serbi, dhe Kroaci dhe Bosnje dhe në gjithë botën. Pra, si që është Mandela për mua dhe për ju një standard, siç është Natasha një standard, unë mendoj se ne duhet të kemi shumë njerëz nga Kosova që do të bëhet ky standard, dhe ky është hapi për të cilin nuk ka asnjë arsytim dhe nuk mund të pritët, ju e dini. Unë kam qenë, ne kemi qenë, dhe më këtë ta përfundoj bisedën time. Mendoj diku vitin 1999. Për herë të parë ishte një delegacion i përbashkët në të cilin do të thotë kanë qenë dhe njerëzit të Republikës Serpskes nga Federacioni, do të thotë Serbëve, Kroatëve, Boshnjakëve dhe të gjithë, ne kemi qenë si një delegacion i përbashkët të Bosnjës dhe Hercegovinës në Forumin Ekonomik Botëror në Davos. Dhe jemi ulur për të ngrënë darkë, aty ishte një politikan i sotëm, në atë kohë nuk ishte një politikan, ai ishte një intelektual i pavarur, Mladen Ivaničević për të parën herë jam ulur me dikën që ka qenë gjatë tërë luftës në Banja Lluk. Pra, e para herë që unë jam ulur

rreth një tryezë. Dhe pastaj i pyeta para disa nga njerëz aty të pranishëm : Mladen, kur do ta rregulloni Ferhadijen? Ferhadija është xhamia, një nga më të mëdhatë në Ballkan, e cila ka qenë tërësisht e rrafshuar me tokë në vitin 1993. në Banja Lluk. Mladeni më shikoi disi kështu dhe tha, mendoj se pak nuk e ka ndier vetveten mirë por tha: "Por, ende është herët! Pra, kjo ishte në vitin 1999. 3 vite pas luftës, pas Dejtonit. Tha: Ende është herët! Unë i them: " Përse Mladen është herët? Çka duhet ende të ndodh? Kur është koha e duhur? Çfarë do të thotë – herët është?! Unë i them: A e dinë kujt i duhet më së shumti Fehradija? Ai më pyet: Kujt? Unë i them: Serbëve! Kështu, xhamia është e myslimanëve, por në fakt ajo më së shumti i duhet Serbëve, për të thënë e shihni në tani jemi duke i kthyer gjërat në nivelin e qytetërimit. Kështu që unë mendoj se, të gjithë që jetojnë në Kosovë i kanë të njëjtat drejta të njeriut. Më së shumti i duhet-shqiptarëve, sepse në atë mënyrë shqiptarët do të thonë: Edhe ne tani kemi krijuar njohuritë tona se si fitohet liria dhe si respektohen drejtat e njeriut në i transmetojmë të tjerëve. Kështu që mendoj që secili që jeton në Kosovë duhet ti ketë drejtat e njeriut të barabarta. Unë mendoj se është shumë e rëndësishme që ne sot jemi ulur këtu dhe unë mendoj se është shumë e rëndësishme, nuk po mundem mjaftueshëm për të nënvizuar se sa e rëndësishme është që shqiptarët sot, shqiptarët e Kosovës në Evropë të jenë kampionët e të drejtave të njeriut. Unë mendoj se ky është çelësi për të drejtat e njeriut evropiane. Pra, juve ju takon një përgjegjësi e madhe jo vetëm për Kosovën, juve ju takon jo vetëm për regjion juve ju takon përgjegjësia për gjendjen e të drejtave të njeriut në Evropë. Përgjegjësia më të madhe e marrin politikanët. Përgjegjës janë dhe artistët, sepse drejtësia artistike është më shpejt se drejtësia ligjore, mesazhi artistik është më i thellë e largpërçues se sa mesazhet e politikës. Ju faleminderit! Më vjen keq se ju mora pakëz më shumë kohë.

Sarah Maliqi: Faleminderit shumë për këtë. Nuk kisha shtuar kurgjo sepse po më duket ishte shumë e qartë porosia, shumë me vend dhe potencon edhe rolin tonë dhe përgjegjësitë tona si individë por edhe si një shoqëri. Unë kisha dashur me ia dhënë fjalën zotit Salem Çorbo e pastaj ta bëjmë një pauzë të shkurtër për një kafe dhe të kthehemi e të vazhdojmë me diskutime lidhur me krejt këtë. Besoj se edhe ju keni dëshirë të thoni diçka. Faleminderit!

Salem Çorbo: Më duhet filluar me diçka që ma kujtoi Harisi. Në historinë tonë disi të gjithë i kemi përjetuar traumat, e ajo çka unë direkt jam përkujtuar është 4. Prilli vitit 1981. Unë isha në Bijelinë, sapo diplomova në fakultetin e filozofisë dhe atë ditë e caktova themelimin e klubit të studentëve në Bjelinë. Pas kësaj mbrëmje kam shkuar për të luajtur basket me shokët e mi dhe erdhën dy makina të policisë për të më marr, më çonin në shtëpi ku unë i ndërrova rrobat dhe gjashtë orë isha në polici duke ju përgjigjur pyetjeve – Çka unë dua të bëjë në Bjelinë? Si, klubi universitar? Se si jam unë i lidhur me studentët në Prishtinë? Dhe unë nuk e dija se atë ditë ishin demonstrata më 4. Prill 1981. Pjatat e rrotulluara, pastaj njëri nga inspektorët më në fund më tregoi se kjo është kjo, pastaj ka ardhur një politikan i cili më njihte mirë, presidenti i të rinjve në atë kohë, dhe më nxori jashtë pas gjashtë orëve. Jam duke folur sikur të gjitha këto kanë qenë të ndërlydhura dhe si më duket të gjitha gjatë kanë me qenë të lidhura si rajonale. Çfarë shpreh unë, është kënaqësia e ime që jam këtu, dhe ky është tubim i artistëve. Në këtë mënyrë unë do të përpiqem me sa duket të flas bash në këtë drejtim shumë shkurt. Në fillim vetëm do të citoj një rast të madh me një artist Pablo Picasso, i cili, sipas meje më së miri ilustron marrëdhëniet e artistit ndaj krimit dhe ndaj të gjithëve që ai përmban. Kur ai u arratis në Spanjë, ka qenë nën hetime dhe në pyetjen: A e kishte bërë aj "Gerlikun,"? ai ju tha -:Jo! Gerliku e keni bërë ju unë vetëm jam përpjekur për të mos e harron askush

dhe kurrë. Unë mendoj se në këtë përgjigje Pablo Picasso me kaq pak fjalë ka ndërtuar vetë pushtetin dhe përgjegjësit të artistëve ndaj krimit, ndaj viktimave, heshtjes, ndaj shoqërisë, ndaj rimëkëmbjes shoqërisë. Do ti citoj disa artist të tjerë të cilët janë ballafaquar më popullin, kryesisht me krerët të atij momenti. Gjithmonë më kujtohet i madhi Bertolo Breht i cili kurrë Hitlerin nuk e ka quajtur me emrin e tij në tekstet, në këngë të veta, por e përdorte termin " Iyrësi i vogël" duke aluduar në shkollën e artit e cila ishte kryer pa sukses dhe më atë e simbolizoi kombin Gjerman kë e morri për udhëheqës. Bertol Breht kurrë nuk e prononcoi emrin e tij. I madhi Thomas Man në radio emisionet e tija duke ju drejtuar popullit gjerman hollësishëm si tani Harisi duke folur, duke folur për popullin gjerman që prej Hitlerit dhe vetë aj do të ketë probleme të mëdha, dhe absolutisht në fund e kishte drejtë. Një numër i madh i artistëve në fakt nuk kanë heshtur mbi krime Më kujtohet kur isha i detyruar ta lëshoj Bjelinen dhe u përgatita në mesnatë. Gjithmonë më kujtohej fjalët Joseph Brodski cili pas 28 viteve me sa më duket mua ... për tu kthyer në Moskë, fitues i çmimit Nobel për poezi, letërsi, dhe ku pothuajse e gjithë shoqëria e priten në këmbë, artistët, dhe politikanët dhe të gjithë të tjerë. në këtë regjion... Dhe ai e ka thënë me një rast një fjali të cilën unë e kam kuptuar tek atë natë kur duhej të ikja nga Bijelina, si dhe shumë të tjerë në këtë rajon. Ai atëherë ka thënë: Njeriu mund të jetojnë kudo, por mund të drejtohet vetëm aty ku është i poshtëruar, vetëm në atë vend mund përsëri ta kthej dinjitetin e vetë. Aty munden ti ndihmojnë ata që e kanë bërë punën për ta poshtëruar. Harisi e përmendi Ernesto Hemingvej dhe unë do të them vetëm një episod nga Lufta e dytë botërore kur Ernest Hemingvej ja ofroi ushtrisë aleate jahtin Pilar, për ta mbushur me eksploziv dhe kur afrohen nëndetëset gjermane Hemingvej ta eksplodon. Për fat të mirë ushtria aleate e refuzoi të Hemingveji arriti të shkruaj dhe " Plaku dhe deti" dhe disa novela të tjera. Por mungesa e forcës të Ernesto Hemingvejit pranë forcës së ligë e cila ishte në pushtet ai do të sakrifikonte vetën për të shkatërruar një nëndetëse gjermane çka ilustron si një nevojë tejet e nevojshme për t'u kundërvënë të ligës. Poeti i madh anglez Jon Don e shkroi një këngë, dhe Hemingveji e mori një pjesë të këngës, dhe e titulli librin e vetë " Pas kujt zile bize." Unë duhet ta ndryshoj pakës nuk e kam me vete por ajo shkon kështu: Asnjë burrë nuk është plakur i vetmuar për vete
Secili njeri është pjesë e kontinentit
Pjesë e gjithësisë
Dhe nëse e këput një copë tokë
Si ta kishe këputur kontinentin,
Si ta kishe këputur vetën
Për atë kurë mos pyet pas kujt zile i bie
Ajo gjithmonë vije pas teje

Mendoj ky kozmopolitizëm, ky universitet të cilin artistet më së miri e mbanin dhe e ndjejnë në mënyrë të përkryer dhe të lehtë mund të aplikohet në atë që ka ndodhur në rajonin tonë. Dhe unë pas një ekskursion në lidhje me artistet ndaj krimit do të kthena në atë për çka jemi ne këtu. Unë dje diçka fola në lidhje me të. Kam folur për nevojën e perceptimit rajonal e të gjithë kësaj çka na ka ndodhur në fundit dhjetë vitet e mileniumit të kaluar me një ... çrregullim,i cili filloi në Veri të Sllovenisë e pastaj u transferua në Kroaci, absolut dhe eruptiv kulmin e arriti në Bosnje dhe Hercegovinë dhe përfundoi në Kosovë. Aq shumë është e përzier dhe aq shumë është e ndërlydhur, pasojat janë kaq të

mëdha, janë bërë shtetit të rinj dhe kjo ka ndodhur ajo që unë thash dje, unë jetoj në Bijelinë dhe dje e mora një shembull, kur ... më 1 Prill njësit erdhën në mëngjes nga baza e Erdutit dhe thjesht e sulmuan qytetin dhe e vranë një numër të madh të civilëve. Selektivisht është vrarë një numër i madh i shqiptarëve. Ky ishte pësimi më i madh i shqiptarëve në Bosnje dhe Hercegovinë i luftës, të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë. Trupat e tyre u transportuan menjëherë familjeve në afërsi të Tetovës, numri më i madh por edhe në vende të tjera. Ata janë varrosur pa obduksion dhe pa analiza forenzike. Tani vetëm familjet e tyre e dinë se ata janë vrarë në Bijelini në prill vitit 1992. Nuk ka njohuri në lidhje me këtë. Nuk ka lëvizje të procedurave gjyqësore. Ne si organizatë që veprojmë në Bijelinë ishim të pafuqishëm për shkak se vrasësit atë natë kishin ardhur jashtë kufijve të Bosnjës dhe Hercegovinës, ata, erdhën nga Serbia, atëherë nga pjesa e Sllavonisë, të cilën e ka mbajtur kjo ushtri. Dhe sot nuk janë trupat e këtyre shqiptarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe shumë të tjerë. Nuk janë më në Bosnje dhe Hercegovinë, janë transportuar dhe janë varrosur kështu siç ju thash të tjerëve janë hedhur në lumin Drina dhe janë varrosur në varrezat duke shkuar nga Sremska Mitrovicës dhe pothuajse deri tek Beogradi. Si të arrimë te e vërteta, kur asgjë nuk është në domenin e autoritetit, as në Bosnje dhe Hercegovinë, e mos të them të sektori civil. Ideja që qeveritë, autoritetet politike të rajonit, domethënë qeveritë dhe parlamenti i këtyre vendeve në kohë për 2 vjet me presion dhe të gjitha mënyra të tjera, për të marrë guximin dhe forcën për ti ngritur më lart mbi partitë politike për të formuar këtë koalicion, sepse vetëm shtetet mund ta formojnë, jo koalicionin, por komisionin, dhe t'i japin një mandat të qartë se do të jetë krejtësisht identike në çdo pjesë ku do të përpunohet dhe të trajtohet, me kritere plotësisht të njëjta, me qasje plotësisht e njëjtë ndaj çdo viktimë, po e përsëris ndaj çdo viktimave në frymë e kësaj që e tha Harisi. Unë mendoj që i gjithë rajoni e ka shansin për të dalë në skenë historike me një hap të ri, kryesisht me forcat e freskëta, për tu ngritur. Kjo është diçka si shtetet që e kanë bërë pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë, të cilat gjithashtu kanë luftuar mes vete, ku ka pasur qindra dhe qindra dhe miliona viktima. Prandaj, Komisioni do të shpërblente gjithë këtë përpjekje të sektorit civil për të arritur deri tek të dhënat gjithkund nëpër arkiva. Ne e dimë se të gjitha të dhënat janë në arkiva. Ne e dimë se strukturat policore dhe ushtarake në të gjitha vendet e dinë fatin e të zhdukurve. Për fat të keq unë do të jap vetëm një pjesë, pjesë të shpejtë të imazhit të Bosnjës dhe Hercegovinës: Mbi 100 000 të vrarë, kjo është ajo çka është themeluar zyrtarisht, 13 000 të zhdukur, 14 vjet pas luftës ne i kemi 13 000 të zhdukur. Dy-tre vitet e fundit ky numër nuk po zvogëlohet, 2.5 milion të dëbuar. Jemi duke pritur 1 milion për t'u kthyer në Bosnje dhe Hercegovinë. Tek në vitin 2003 e kemi formuar gjyqësinë në nivelin shtetëror, gjyqësia është e dobët. Si të kryejmë procesin mbi 100 000 të vrarë? Si të organizohem për ti gjetur 13 000 të zhdukur? Nëse nuk kemi qasje në arkiva, në qoftë se nuk ka forcë e cila do ti ngritë politikanët për atë që e thash. Në të njëjtën mënyrë në të cilin kanë bërë rreth 13 dhe diçka vende, në një mënyrë që do të na mundësonte këtë për të cilën fliste dhe Harisi, e kjo është një e tashme me perceptim absolut për ardhmen më të mirë. Mendoj se artistët janë me të vërtetë në radhë të parë së bashku me ne njerëzit që janë në të drejtave të njeriut, se ne duhet për të parë më shumë dhe më gjerësisht mbi të tjerë dhe duhet të jemi një mjet i madh i politikës, që më shpejtë, më efikase dhe shumë më thjeshtë ti zgjedhim problemet. Njerëzit të cilët jetojnë, dhe unë përsëri e përsëris, kryesisht në thelb të gjithave është viktima, por dhe komplet shoqëria me të gjitha traumat e saj. Unë kaq, në paraqitjen time.

Sarah Maliqi: Faleminderit! Dëgjuam folësit, dëgjuam lidhur me iniciativën për KOMRE, dëgjuam angazhimin, dëgjuam se çka do me thënë me qenë obligimi ynë personal por edhe si shoqëri në ndërtimin e asaj që e quajmë të kujtimit dhe mos harrimit, që viktimat të mos jenë vetëm në numra por me emra e mbiemra dhe unë kisha me propozuar tash të bëjmë një pauzë të shkurtë e mbasi të kthehemi të bisedojmë në kontekst të Kosovës se çka ka ndodhë, sa kemi qenë të angazhuar dhe ndoshta pak më konkret se zotëri Haris pak më shtyu e më nguci edhe mua personalisht. Pra, cilat janë ato dhe si e shihni ju vetë rolin ose kontributin tuaj në ndërtimin e kësaj kulture në një anë po edhe po ashtu kishim pas qejf me dëgjua edhe komente ose propozime konkrete lidhur me krejt këtë iniciativë që ju prezantua juve sot këtu.

Pauzën po e bëjmë për 15 minuta. Ju kisha lutur të vini në kohë! Faleminderit!

(Pas pauze)

Shukrije Gashi: Në shtetet ku ka pasur luftëra dhe konflikte të armatosura dhe kush janë kategoritë më të atakuara, natyrisht viktimat dhe ato të kategorive të ndryshme. Për shembull, ne rastin e Kosovës mund të themi se menjëherë pas luftës një pjesë e ish të burgosurve nuk u trajtuan ashtu siç duhet, që ishin pra të burgosur gjatë periudhës së luftës. Tek-tuk ndonjëherë, organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe shoqatat e ndryshme bën përpjekje por jo në masën e duhur dhe sot e kësaj dite vazhdojnë të mos bëjnë përpjekje të mjaftueshme. Askush në mënyrë serioze nuk është marrë me gjendjen as materiale, as morale, as sociale dhe as fare në Kosovë me kategoritë e veçanta, domethënë kategorinë më të atakuar – viktimat. Ende asgjë konkrete, po flas në rrafshin e Kosovës, nuk është bërë nga organizata, që veten e quajnë kompetente, që të merren në mënyrë serioze me këta njerëz. Ka prej tyre që vazhdimisht theksojnë se bëjnë dhe ndoshta kanë bërë, mirëpo ato të dhëna, faktet dhe argumentet nuk i janë ofruar asnjëherë publikut në masën e duhur dhe në mënyrë zyrtare. Ne jemi të vetëdijshëm se Kosova ka kaluar në një periudhë shumë të vështirë të pasluftës, duke u ndodhur në mes të disa qeverive të huaja dhe ka qenë shumë vështirë për shoqërinë civile gjithashtu që ta luajë rolin e duhur dhe shpeshherë të marrë barrën të cilën vështirë e ka që ta realizojë. Mirëpo, ne jemi të vetëdijshëm se ky është edhe roli i shoqërisë civile. Domethënë, roli i ndërgjegjes së shoqërisë. Ju sigurisht patë se sa i rëndësishëm është dëgjimi i viktimave në komision, rrëfimet e tyre prekëse dhe nevojën që viktimat të deklarohen, ta thonë atë që e mbajnë thellë në shpirt dhe atë që i kanë lënduar. Është një formë e krijimit të hapësirës për ta, është një formë e ofrimit të ndërgjegjshëm të dëgjueshmërisë sonë për ta dhe përmes kësaj forme t'i bëhet një pranim publik se është dëgjuar, se vërtetë është viktimë, se meriton kujdes në të gjitha format të cilat i theksova më herët. Domethënë, këtu janë një sërë komponentësh të shoqërisë së organizuar, edhe në sektorin civil, edhe në atë qeveritar në mënyrë që të mund të arrihet një kujdes i merituar për viktimat. Pastaj, sigurisht se përveç dëmshpërblimit, janë të nevojshme edhe reformat kushtetuese dhe ligjore, të cilat po ashtu ia mundësojnë një trajtim të dinjitetshëm viktimës. A ka ndodhur kjo në vendin tonë? Sigurisht se s'ka ndodhur. Ka pasur përpjekje që të bëhen reforma ligjore, të hartohen ligje mirëpo ende ka ngelur në fazën e hartimit e të shqyrtimit dhe nuk është bërë as në këtë rrafsh. A ndodhi diçka për viktimat në rrafshin social dhe shëndetësor, në sigurinë e familjeve të tyre, atyre të cilët kanë mbet të gjallë? Nuk ndodhi ende asgjë. Ende nuk ka ndodh asgjë me mbetjet mortore të viktimave dhe edhe në këtë

rrafsh ka shumë hapësirë dhe nevojë që të bëhet më shumë në mënyrë që viktimave t'iu kthehet dinjiteti, që ata të dinë se e kanë kujdesin e shoqërisë. A është bërë diçka në arsimimin e qytetarëve të Kosovës, në këtë rrafsh? Përsëri po e them, jo në mënyrë të organizuar. Ka pasur tentativa tek-tuk, brenda Kosovës po flas dhe individët e caktuar të cilët kanë dëshiruar që në mënyrë individuale të marrin pjesë nëpër organizime, në konferenca, në rajon, jashtë vendit dhe të marrin informacione që të arsimohen në këtë drejtim. Mirëpo, në mënyrë të organizuar, nuk ka pasur asnjëherë. Për rajon mund të flas se një iniciativë të tillë, për herë të parë, e ka marrë Fondi për të drejtën humanitare nga Beogradi, zonja Natasha Kandiç dhe vërtet ka bërë mirë për ta. Për pjesën dërrmuese konsideroj për jush, Natasha Kandiç është e njohur për arsye se ka bërë punë të madhe në Kosovë, edhe para luftës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Pikërisht atëherë kur ishte më së vështiri që informatat të depërtonin jashtë Kosovës për shkelje të shumta të drejtave të njeriut që nga vitet e 90-ta e tutje po edhe më herët. Fondi për të drejtën humanitare ishte një dritare në të cilën mund të depërtonin raportet që dërgoheshin nga atëherë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe po ashtu përmes Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut, kur unë atëherë isha njëra nga themeluesit, bashkë me Adem Demaçin dhe të tjerët të këtij Këshilli dhe, megjithëkëtë, ekzistonte një kthinë, një hapësirë për frymëmarrje për shpërndarjen e informatave. Natasha Kandiç, edhe gjatë luftës, edhe pas luftës kur ishte sërish më së vështiri, gjithmonë u përpoq dhe gjeti mundësi për të depërtuar aty ku të tjerët nuk mund të depërtonin dhe ndoshta kishin frikë dhe nuk kishin mundësi të depërtonin. Dhe ky është, sinqerisht, misioni i aktivistëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe dihet se të tillët i çojnë punët deri në fund, për arsye se besojnë në misionin e tyre. Dhe pikërisht këtë e bëri. Para jo shumë vitesh e ndërmori këtë iniciativë dhe kësaj iniciative pastaj iu bashkëngjithën edhe dy organizata të tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut – Dokumenta nga Kroacia dhe tjetra Qendra për të drejtën humanitare nga Bosnja dhe Hercegovina. Unë fillimisht mora pjesë, atëherë edhe kur mësova për këtë çështje, në disa këshillime dhe vërtet kam konsideruar dhe jam bindur se kjo është gjëja më e rëndësishme që i nevojitet rajonit e që nuk është bërë që në radhë të parë të bëjmë çmos që të ngritet vetëdija e qytetarëve kudo në ish vendet e Jugosllavisë që viktimave t'iu kthehet dinjiteti, ato të pranohen publikisht se janë të tilla, ta kenë kujdesin e merituar si atë material, social, ekonomik, shpirtëror, të sigurohen materialisht që të ngriten memoriale dhe që njëherë e përgjithmonë në kujtuesen e gjeneratave që vijnë të mos ngelet barra se ndodhi diçka që ishte e trishtueshme dhe nuk u bë asgjë që të zbardhet ajo, që të shënohet si një histori e cila duhet të kujtohet por që nuk duhet të përsëritet. Prandaj, vendosa që të jam pjesë e Koalicionit për themelimin e KOMRA, një Komisioni rajonal për përcaktimin dhe gjetjen e fakteve për të vërtetën dhe unë konsideroj se sot, në mes jush, meqë mbi të gjitha jeni krijues dhe imagjinata e krijuesve mbërrin atje ku nuk mbërrin zakonisht shpeshherë imagjinata e njerëzimit. Në botën e juaj të krijuesit ju do të gjeni hapësirë që përmes formave të shprehje artistike ta keni pikëpamjen tuaj, ta shfaqni botën e juaj që ndërlidhet me këtë fushë e cila është shumë e rëndësishme, që të krijohen sërish urat e fqinjësisë së mirë, që gjenerata juaj dhe gjeneratat e ardhme të përpiqen që pa ngarkesë të integrohen në botën qytetëruese pjesë e së cilës besoj dhe shpirtërisht jemi të gjithë ne, por që ende edhe tutje duhet bërë që të mbërrijmë atje ku të tjerët kanë arritur kohë më parë. Andaj, krijimi i një komisioni rajonal për përcaktimin dhe gjetjen e fakteve e ka rëndësinë e vet të veçantë dhe dikush do të pyeste pse pikërisht rajonal. Pikërisht rajonal, për faktin se ata

të cilët kryen krime ose vepra penale, ata të njëjtit pothuaj se u sollën gjithkund në shtetet dhe vendet e ish-Jugosllavisë dhe askush në këto vende veç e veç nuk do të mund ta realizojë gjetjen e kryerësve të veprave penale dhe sjelljen e tyre të plotë para drejtësisë. Domethënë, nuk do të jemi në gjendje që të kemi një vendosje të drejtësisë objektive, në qoftë se nuk do të kemi mundësi që të këmbejmë informatat dhe gjithashtu të mbetjeve mortore, domethënë të atyre të cilët, ndoshta, u vranë në Kosovë, kurse u bartën dhe u varrosën diku tjetër. Për ata që ishin të pranishëm që nga fillimi këtu, të dy zotërinjtë që sot janë të pranishëm këtu me ne nga Bosnja, ofruan mundësi për të kuptuar për të gjithë ne se përmes, të them, shembujve të tyre sa i rëndësishëm është bashkëpunimi rajonal përkitazi me krijimin e këtij komisioni për përcaktime dhe gjetjen e fakteve. Për shembull, rasti që e përmendi zotëria Salem Çorbo me grupin e shqiptarëve, të cilët u ekzekutuan dhe u varrosën pa u bërë identifikimi i tyre. Do të thotë, këto janë ato përvojat të cilat në mënyrë të ndërsjellë do të na ndihmojnë që përmes këmbimit të informatave dhe gjetjeve, zbardhjeve të fakteve të mund të realizohet një punë e suksesshme e Komisionit i cili është më se i nevojshëm. Kjo ditë e sotme, po mos të ishim sot këtu, do të ishim mangut për këto informata kaq të vlefshme që i dëgjuam sot dhe se besoj që në imagjinatën tuaj të krijuesit do të nguliten thellë dhe do të ndikojnë që në të ardhmen e afërt të përcaktoheni pse duhet ndihmuar një iniciativë të tillë. Dhe besoj se kjo ju ka shërbyer shumë mirë. Kujtoj se prej këtu, kur do të largoheni, do të keni çka të bartni tek të gjithë njerëzit që ju i njihni dhe konsideroni se janë njerëz të vullnetit të mirë për të ndihmuar iniciativat e tilla. Për punën e Komisionit, për më tutje, unë besoj se ka çka të ju thotë dhe sigurisht do të ju thotë edhe përfaqësuesi i Qendrës për të drejtën tranzicionale zotëria Bogdan Ivanisheviq, në mënyrë që më qartë dhe më mirë, në mënyrë të strukturuar ta kuptoni funksionin e këtij Komisioni. Unë pak më shumë u lëshova në rrafshin e reflektimit nga filmi që e pamë, për arsye se jam njëfarë lloj krijuese, gjithashtu merrem edhe me shkrime dhe mendova se si krijues që jeni, fantazia juaj është më shumë e orientuar jashtë kornizave. Mirëpo, çështja për të cilën po flasim vërtet duhet të jetë e strukturuar dhe të futet në korniza. Ta ketë, jo vetëm emrin si Komision por të funksionojë si Komision i strukturuar dhe të ndihmojë që njëherë e përgjithmonë t'u kthehet dinjiteti viktimave dhe të vihet drejtësia në vend. Kaq kisha. Ju faleminderit!

Sarah Maliqi: Faleminderit, Shuki! Po e hap diskutimin, urdhëroni!

Bogdan Ivanišević: Unë ndoshta nuk kisha dashur të ... të flasë me detalisht për komisione për shkak të kësaj, çka tani e tha Shukria. Unë këtë nuk e kisha bërë sepse është ora një e gjysmë, e kur ja kisha nisur unë me fol kishte me zgjat deri tek ora tre unë me të vërtetë dëshiroj që njerëzit që janë rreth tavolinës që ata të flasin, e ne të tjerët, eventualisht të futemi me disa sqarime, nëse është e nevojshme.

Sarah Maliqi: Faleminderit Bogdan! Sigurisht se biseda mund të bëhet sipas agjendës, kështu që vazhdojmë me diskutimet. Jeni të mirëseardhur që të komentoni përkitazi me këtë që u tha dhe me filmin, cilat janë përvojat dhe pikëpamjet tuaja përkitazi me këtë. Faleminderit! Po mendoj, ndoshta janë informatat, por prapë ka informata për të cilat besoj se për pjesëmarrësit që i kemi ftuar sot ka ndonjë mbresë dhe përshtypje dhe unë ju thërras për ndonjë koment, të thoni diçka.

Albert Heta: Ok. Mund të flas, serbisht, anglisht, shqip. Shqip po flas, më lehtë po më vjen. Ashtu sikur që e tha zotëria prej një ftese për konsultime më tepër patëm ligjërata se sa që besoj që kishim mund të konsultohemi lidhur me diçka brenda kësaj dite. Jo se kam shumë mendim lidhur me këtë komision apo shumë informata por prej materialit të ofruar

prej Sares, e kam kuptua më tepër për çka bëhet fjalë. Në të vërtetë, i kam disa vërejtje parimore, sepse më shumë po e ndiej veten këtu si njëfarë vështruesi i asaj çka po ndodh dhe kam me u mundu të jam kritik aq sa besoj që veç duke qenë kritik mund të ndihmohet ndonjë nismë e tillë, apo jo. Së paku, zotëriut Haris i them se, po Sarajeva ka qenë e rrethuar për katër vjet. Kosova ka qenë e rrethuar dhe e okupuar për dhjetë vjet. Kosova është okupuar në vitin 1989, nuk është okupuar në vitin 1999. Këtë e them vetëm sa për ta vendosur një perspektivë reale historike dhe mos me krijua teza të paqëndrueshme, sepse, nëse vetë anëtarët apo të ftuarit e këtij komisioni nuk kanë ndjesi për pas njohuri më të thella se me ato që shërbehen zakonisht, atëherë kem me pas probleme më të thella. Tjetër. Të gjitha vërejtjet do të janë të vogla, por për mua janë shumë të rëndësishme. Organizatë ftuese, apo ftues i këtij konsultimi për mua është Sara Maliqi e jo zonja Natasha Kandiq. Zonja Natasha Kandiq është mysafire. Po dua me dal në esencën e vërejtjes time. Besoj se një komision rajonal do të jetë jofunksional në Kosovë. Unë besoj për një komision të Kosovës i cili natyrisht se do të ndërlihej me punën e komisioneve të ngjashme në vendet e ish-Jugosllavisë. Rrethanat specifike të asaj çka ka ndodhur në Kosovë, po edhe rrethanat specifike të funksionimit të Kosovës brenda strukturës së ish-Jugosllavisë mendoj që e përjashtojnë një rëndësi të suksesit të një komisioni rajonal, i cili kishte mund të merret me, të themi, të vërtetën këtu. E vërteta këtu, për shumicën e njerëzve, është e qartë. Të vërtetën këtu dhe atë çka ka ndodhë, njerëzit këtu e thonë vazhdimisht. Problemi është që këtu nuk ka kush t'i dëgjojë. Për mua është shumë simptomatike se e vërteta vazhdimisht tregohet në vendet e viktimave e nuk tregohet në vendet e atyre që i kanë bërë krimet. Do të thotë për mua ekziston problem, pasi që këto nisma, tentohen të funksionalizohen, të themi në Kosovë dhe në Sarajevë, ndërsa problemet kryesore të cilat ende nuk janë zgjidhur edhe sot ekzistojnë me vendin i cili vazhdon të mohojë idenë prapa luftërave që kanë ekzistuar në Kosovë. Unë nuk besoj që luftërat në ish-Jugosllavi, kjo është njëfarë teze e normalizimit që çdo 50 vjet popujt në Ballkan çohen dhe e vrasin veten, masandej e vërejnë fqinjin e tyre. Pas këtij projekti ka ekzistuar një projekt i qartë. Ekzistojnë ata që e kanë vu projektin në veprim, ekzistojnë edhe viktimat. Nuk mund të jemi të gjithë ne viktimat. Unë besoj që aty është edhe ai që e ka bërë krimin. Tjetër, çka desha të them? Thjeshtë për ta përmbledhur, nuk kam kurrfarë vërejtje për nismën, përveç asaj se nëse kjo funksionalizohet në një kontekst real, krijimi i komisionit të Kosovës i cili në njëfarë forme do të koordinohej me komisionet e ngjashme apo të themi, ndoshta do të formohet një komision për pjesë tjera të ish-Jugosllavisë, do të kishte me qenë më funksional në raport me kontekstin për të cilin lufta këtu ka ndodhë. Lufta këtu ka ndodh dhe okupimi është injoruar prej vitit 89 prej të gjitha pjesëve të tjera të ish-Jugosllavisë, forcat federale në të gjitha pjesët e ish-Jugosllavisë kanë qenë të përfshira në procesin e, të themi, të rrënimit të autonomisë së Kosovës. Andaj aspak unë nuk çuditem, të themi, me mosbesimin dhe me njëfarë lloj tërheqjeje taktike që njerëzit këtu e bëjnë ndaj iniciativave rajonale të ish-Jugosllavisë. Pa e mohuar aspak rëndësinë e koordinimit në mes këtyre nismave. Kaq pata tash për tash. Kam edhe sende tjera por nuk dua të marr kohë, ndoshta më pas e kërkoj fjalën.

Sarah Maliqi: Kështu, Albert! Ftesa ka ardhur në emër timin, por në ftesë shënohet që kjo është iniciativa së bashku me koalicionin. Iniciativa është pjesë e koalicionit dhe ne e kemi marrë përsipër këtë organizim sot. Natasha Kandiq është mysafire por jemi pjesë e koalicionit edhe Shukrije Gashi me "Partners Kosova".

Albert Heta: E qartë nuk kam aspak kundër. Për mua është shumë me rëndësi pozicioni fillestar, prej ku fillon nisma. Sepse unë besoj që ajo e garanton edhe suksesin e nismës.

Sarah Maliqi: Po, unë desha me u ndërlidh sepse nisma është vendore. Për këtë shkak edhe jam e ulur unë sot këtu, Shukrije Gashi e plotë të tjerë. Po unë po dua përgjigjen me ta dhënë për atë që është lajmëruar për disa çështje tjera. Po mendoj s'mund të jam e Serbisë kur jam e Kosovës, kështu që kjo është nisma vendore që ne mendojmë ta përkrahim.

Natasha Kandiç: Do të doja të ju njoftoj me disa informacione. Unë nuk e di se a ka libri "Raporti i Komisionit të Kosovës." në bibliotekë. Ky është raporti i Komisionit më të cilin ka udhëhequr Riçard Goldston, prokurori i parë Tribunalit të Hagës. Unë do të thosha se bashkësia ndërkombëtare, ose Grupi i Kontaktit, që menjëherë pas Qershorit në vitin 1999. E kanë krijuar një komision anëtarët e të cilës kanë qenë ekspertët e drejtësisë humanitare, ata që e kanë gëzuar një reputacion të madh në tërë bashkësinë e juristëve në botë. Richard Goldstone ka qenë anëtar i Komisionit të Afrikës së Jugut. Ai është gjyqtarë, ka kryer detyrën e prokurorit në gjykatën e Hagës, ka kryer të panumërta shumë të lartë, funksione shumë veçori në lidhje me konfliktet e armatosura. Shumë herë ishte negociator i drejtpërdrejtë në situatat e konflikteve të armatosura. Pranë tij anëtare e Komisionit ishte Mary Kaldor. Ajo është profesore në Shkollë në Londër në Shkencat Ekonomike. Unë tani në këtë moment nuk po mundem ti kujtoj dhe katër anëtarë të tjerë të Komisionit, por Komisioni në raportin e tij absolutisht e ka përfshirë çdo gjë që ka ndodhur në Kosovë. Aj ka qenë një raport më profesional, gjithë përfshirës lidhur me atë që ndodhi në Kosovë, por i shkruar në gjuhën e nivelit të ligjit humanitar ndërkombëtar. Pra, nuk është i dedikuar viktimave, por flet në lidhje me krimet e luftës që kanë ndodhur për krime kundër njerëzimit, përshkruajnë dëbimin, rreth vrasjes masive në Kosovë. Kjo është një njohje ndërkombëtare e viktimave shqiptare. Pra, duhet të keni para sysh këtë, se viktimat shqiptare janë të njohura ndërkombëtarisht edhe në këtë mënyrë, ka qenë i formuar komisioni i posaçëm i cili kishte për detyrë ta bëjë përshkrimin objektiv, të saktë dhe mbi të gjitha në gjuhë të drejtës ndërkombëtare humanitare se çka ka ndodhur dhe për të emëruar jo konkretisht, jo individuale, jo autorët por forcat, forcat e armatosura që janë përgjegjës për atë që ndodhi në Kosovë. Unë vetëm këtë e desha dhe mendoj se ky libri është në të gjitha bibliotekat e botës, kjo është diçka që mua më duket se askush nuk mund të shkruaj më mirë kur ekziston një përshkrim i asaj që ndodhi në Kosovë, por nga pikëpamja e shkeljes e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Nuk ka ekspert më të madh se Richard Goldstone. Se Mary Kaldor, e cila kaloi vite këtu në Kosovë, për të mbështetur sa më shumë informacion që të jetë e mundur në lidhje me atë që ndodhi në Kosovë dhe ti sjell në opinion duke filluar nga viti 1991. Mary Kaldor është në katedrën e Londrës Shkencës Ekonomike dhe atje është ky raport, një nga më të mëdhenjtë të letërsisë për seminare dhe diskutime në lidhje me ndërhyrjen në Kosovë dhe me shkeljet të kryera mbi ligjin humanitar ndërkombëtar në Kosovë. Por unë me të vërtetë dëshiroj të dëgjoj nga ju se çfarë do të jetë një mandat, çfarë mendoni se çka do të punon Komisioni. Pra, duke pasur parasysh se Gjykata e Hagës ... Merrni aktvendimet Milutinovic, Ojdaniç dhe të tjerëve. Është në hollësi ... Për shembull, 13 komuna, e përshkruar saktësisht se çfarë ka ndodhur. Në të njëjtën kohë, që ta keni parasysh që është e përqendruar në kryesit e krimit. Viktimat janë në funksion të dëshmisë për atë që ndodhi, por në atë dëshmohet, në këtë aktvendim, përgjegjësia e gjeneralëve, të policisë dhe ushtrisë në Kosovë. E tani unë kisha pasur deshi ta di se çfarë ju mendoni se çfarë do

të jetë Komisioni, Komisioni i Kosovës, me çka saktësisht do të merret në lidhje me atë që ne flasim për krimet e luftës, viktimat, në lidhje me nevojën për njohjen, mbi nevojën për krijimin e kujtesës historike në të cilat identiteti i viktimave do të jetë shumë i rëndësishëm.

Albert Heta: Ajo kishte me bë pikërisht atë që ju e përmendët, nëse jam i ftuar me u përgjigjur. Po unë thjesht mendoj, shoqëria e Kosovës, problemet të cilat i ndanë në këtë aspekt janë shumë shtresore. Ne kemi së pari problemin ende me njëfarë faze të papërfunduar të luftës dhe ende e kemi të pranishëm, të themi, palën që ende e sheh veten si palë armiqësore, apo jo. Mandej kemi problemet brenda shoqërisë, me ndarjen brenda shoqërisë të shtresave të ndryshme të shoqërisë që kanë kaluar në luftë. Do të thotë, ai komision në këtë hapësirë kishte me qenë shumë kompleks dhe i fokusuar në shumë drejtime. Me palën që kemi qenë në luftë ne ende jemi në njëfarë raporti të luftës së papërfunduar. Ndërsa brenda ekziston ai simptomë jo i njeriut të Bllacës, jo i komandantit, jo tregimet tjera dhe viktima, unë pajtohem me ju, manipulohet në raporte të ndryshme brenda këtyre strukturave. Unë besoj se komisioni për Kosovën, në koordinim me komisionet tjera, do të ketë punë të madhe për të bërë në këtë rrafshin tonë të këtij shteti, sepse një komision rajonal shumë vështirë mund t'i prekë detajet e kontekstit lokal. Unë ashtu mendoj së paku, sepse shkohet në njëfarë niveli më të gjerë të problemit. Këto janë vërejtjet e mia që unë i shoh, po them prapë, si vështrues dhe jo si ndonjë njeri që merret me këtë lëmi përveç punës time ku natyrisht ka elemente të kujtesës të cilat janë të pranishme edhe aty. Do të thotë edhe vërejtjet që i them, unë kisha dashur ju t'i shihni si kontribut i vogël në këtë diskutim, asgjë më tepër.

Natasha Kandiç: Nuk e di. Unë jam person të cili duhet ti ketë të gjitha të qarta. Provon. Unë ju kuptoj se mendoni që këtu ekziston një luftë e pakryer, e ne i jemi duke folur për përqendrimin mbi viktimat. Nuk dëshirojmë të... Si mendoni luftë e pakryer? Luftërat kanë përfunduar. Askush më askujt nuk do t'ia lejoj të mbaj armë. Nuk ka më aso gjërash. Serbia është mposhtur në këtë kuptim, është e bllokuar. Asnjëherë më nuk do të jetë në gjendje për të përsëritur asnjë ndërhyrje, asnjë agresion, kurrëfar krime masive. Megjithatë, dhjetë vitet kanë kaluar. Ne duhet të përpiqemi për të bërë diçka, ne në fakt duhet për të gjetur një instrument, një masë për t'iu përgjigjur në atë çka ka ndodhur dhe për mos të themi se ne jemi në një luftë të papërfunduar, por mos të lejojmë më kur të ketë luftë. Për atë unë kisha pasur dëshirë të më ndihmoni ...

Albrt Heta: Duket t'u ndërpre lufta do te kryhet kur futbollerët e Kosovës luajnë në Beograd më futbollerët e Serbisë. Ahere lufta do të kryhet. Futbollerët e Kosovës sot nuk munden të luajnë as në Beograd, por as në Bruksel as në Sarajevë. Qe do të thotë qytetaret e Kosovës nuk munden të udhëtojnë as në Beograd, as në Sarajevë, as në Bruksel ku udhëtojnë me viza dhe radhas. Domethënë, për atë jam duke folur. Nuk jam duke folur për ndonjë normalitet i cili nuk ekziston. Aj normalitet është i mundur vetëm nëse ke bazë, jo vetëm për atë normalitet, por edhe bazën për trajtimin e këtyre gjërave. Problemi është këtu, lufta ende e ekziston në kokat e atyre cilët ende janë duke e luftuar. Unë nuk jam duke thonë se prapë do të luftojmë, apo ashtu disi.

Natasha Kandiç: Në rregull, a dini çka ndoshta është më e dobishme të kemi parasysh atë që ju jeni duke folur. Ky është një proces të krijimit të një shteti sovran. Kosova ka shumë probleme dhe shumë pengesa në rrugë. Por ne të gjithë, duke përfshirë sidomos juve dhe mua, i përkasim një kategorie të njerëzve të cilët mendojnë se Kosova është

shtet i pavarur dhe sovran. Se askush nuk mund të pretendon për Kosovë pas krimeve dhe për krimet e kryera. Kështu, kjo nuk duhet të jete objekt për diskutimet tona. Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm për atë që ju flisni. Por, pasi që ne jemi organizata për të drejtat e njeriut, kjo do të thotë që ne nuk mundemi tani, për shembull, si unë që nuk mundem të dënoj ose ti burgos shumicën për të cilët unë mendoj se duhen të përgjigjen. Gjithashtu, nuk e kam atë fuqi as kush nuk e ka atë fuqi për të thënë ose për ti urdhëruar autoritetin serb që ata ta njohin Kosovën. Por, pasi ne të gjithë jemi aktivistët për të drejtat e njeriut, jemi shumë të afërt me standarde çka është e rëndësishme për një shoqëri për tu zhvilluar mirë. Kjo do të thotë që ne mund siç kërkojmë tani, mendojmë dhe flasim në opinion. Ky është një poshtërim jo vetëm për qytetarët e Kosovës, por dhe poshtërim për neve qytetarët e Serbisë që dikush nuk mund të vijë atje për shkak se ai ka dokumentet e Kosovës, sepse i ka dokumentet e shtetit të cilat qeveria serbe nuk i pranon. Ky është një nivel tjetër. Ne mund ta bëjmë presion dhe vazhdimisht ta shfaqim si një problem deri sa gjendja dhe marrëdhëniet nuk normalizohen. Por kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi nevojë për tu marrë dhe me këtë nivel. Por keni kujdes, ky është një nivel tjetër. Në Serbi ekziston një mohim i krimeve të luftës. Nëse ne nuk punojmë asgjë, nëse ne nuk bëjmë përpjekje për themelimin e fakteve, dhe që këto faktet të jenë të pranueshme, kur institucionet dhe nëse e fitojnë një kontekst rajonal, atë herë është një presion shumë i fortë mbi qeverinë Serbe dhe ajo nuk mund të mohon. Si mbas mendimit tim të thellë, Komisioni i Kosovës ... Në Bosnje dhe Hercegovinë, ka pasur dy tentime për themelimin e një nismë shumë të forta për të formuar një komision kombëtare të Bosnjës. Nuk ka pasur sukses. Dhe në qoftë së do ta kishin themeluar nuk do të kishte sukses, për shkak se faktet në lidhje me atë që ka ndodhur në Bosnje nuk mund të përcaktohet vetëm në kuadër të Bosnje-Hercegovinës, sepse janë, dhe Salem Čorbo shumë më mirë mund të flet rreth kësaj, sepse kryesit e atyre krimeve janë më së shumti ju lutem, ata të cilët morën vendime, të cilët kishin fuqinë për të dërguar grupe të armatosura, për të dërguar të gjithë ushtrinë dhe policinë. Ata nuk janë në Bosnje dhe Hercegovinë. Ato janë të vendosur në Serbi. Gjithashtu, disa janë të vendosur në Kroaci. Prandaj, ky Komisioni kombëtar i Bosnjës mund të jetë i vlefshëm në identifikimin e disa elementeve që kanë të bëjnë me të vërtetën totale, siç është formuar komisioni nën presion por komisioni i formuar i qeverisë Republikës Serpska i cili kishte për detyrë për të ngritur për të përcaktuar faktet në lidhje me gjenocidin e kryer, ngjarjet, nuk ka votuar gjenocidin prej 11 deri tek 19 Korrik. Përpjekje e parë ishte një katastrofë, në atë raport thuhet se myslimanët kanë shkuar në mal dhe atë janë humbur gjurmët dhe pastaj ndermes vete janë mbytur, raporti i dytë është i dokumentuar, i saktë, me emër dhe mbiemër janë cekur 8 000 persona cilat janë pushkatuar dhe likuiduar nga anëtarët e Ushtrisë së Republikës Serpska. Unë dua të ju inkurajoj tani, t'u pyes. Nëse nuk do të jetë përcaktimi i fakteve në të cilin do të jetë i përfshirë gjithë rajoni për të ndihmuar, për ta detyruar Serbin jodemokratike të ndalon të mohon, të kundërshton, të hesht, çka pastaj Kosova, një Komision i Kosovës, mund të bënë. E keni pasur një komision më të mirin të cilin askush deri tani nuk ka pasur mundësi ta merr - Komisioni i Goldstonit askush në botë nuk ka pasur Komisionin e Golstonit. Ju i keni para gjykatës të Hagës aktvendimet ushtrisë dhe policisë Serbe. Ju jeni ndërkombëtarisht të njohur si viktima. Nuk ka asnjë mosmarrëveshje. Por ajo që ne duam, ne nga Serbia, nga Kroacia, në të Organizatës për të Drejtat e Njeriut - ne duam që të bëhet njohja publike. A më kuptoni mua. Ne kemi pasur, nuk e di se sa raporte të botuara në lidhje me atë që ndodhi në Kosovë. Kjo nuk

është e mjaftueshme. Nuk mundemi në ta zëvendësojmë qeverinë. Ne mundemi të bëjmë kësi presioni, presion të vazhdueshëm, me forcën e fjalëve tona për të arritur deri tek ajo për të krijuar një komision apo këtë proces konsultativ. A e dini ju se sa ai është me vlerë. A keni pasur ju ndonjë mbledhje që keni biseduar për këtë. Nuk keni pasur. Ku do që lëviz, në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kroaci ka disa konferenca, por ku jemi iniciator të gjithë ne më së shumti nga Organizatat për të Drejtat e Njeriut, por derë tani nuk ka pasur kësi debat rajonal për të folur për këtë. Është shumë më rëndësi.

Albert Heta: Ka qenë njëherë. Në Novi Sad.

Natasha Kandiç: Kur? Ajo në Beograd? Pra mirë. Ishte dhe këtu përpara, por është i rëndësishëm procesi konsultativ këtu, me grupe të ndryshme. Por është mirë për të folur konkretisht. Unë isha, kur kishim ndihmuar. Ndoshta ne të gjithë do të fitonim më shumë nëse ju kishit provuar për atë parë se çfarë do të punonte Komisioni saktësisht. Komisioni nuk do të merrej me atë a do të luajnë futbollistët kosovarë në Beograd apo jo.

Albert Heta: Me dhënë kontekstin. Natyrisht, unë thash tha se çfarë do të duhet të bëjnë Komisioni. Por kur thua se në opinion duhet të flitet për këtë, ku të flitet publikisht në lidhje me këtë. Ne jemi këtu dhe ne vazhdimisht dëgjojmë në televizionin publik, në mediat nuk janë tregime, por dëshmi. Ky mjedis është i përplot me këtë. Kur thua publikisht a mendoni në opinion të Beogradit, ose ku publikisht. Unë mendoj se është për mua e rëndësishme. Shqiptarët nuk do të jenë, siç ju i quajtet në fillim hamall ... Shqiptarët nuk do të jenë përsëri bartës të të drejtave të njeriut, në fakt nuk do të jetë në gjendje të jetë. Bartësit duhet të jetë shoqëria serbe. Për mua kjo është shumë e qartë. Nuk do të mundet.

Sarah Maliqi: Urdhëroni Nora! Vetëm, ju lus, sa herë që të flisni, të prezantoheni. Nora, pastaj Eli.

Nora Ahmetaj: Alberti, po mendoj e pat... Unë prej fillimi në këto konsultime kam marrë pjesë dhe përshtypja ime si vëzhguese po edhe që kam disa njohuri për këtë temë, krejt kam përshtypjen që po shkojmë e nuk po fillojmë pak në mënyrë më strukturore, më konstruktive, por fjala e fundit po thuhet e para. Ndoshta kjo, po e them për panelistët, Natasha e Shuki në këtë rast, por edhe në të ardhmen është më mirë të shpjegohet, edhe pse ju i keni marrë, ne i kemi marrë të gjitha materialet me i lexu se çka është komisioni. Kjo mund të jetë sa e ... për dikë, mundet të jetë për dikë shumë e kapshme. Kur flitet për komisionin. Komisioni është diçka që ndoshta fjalë e fundit që duhet me u thënë. Mirë kishte me qenë, të shpjegohet çka po duam me bë, sa është ky proces. Në mënyrë krejt kontinuale si fillon, si vazhdon dhe si përfundon. Kur të vihet deri te komisioni do të marrë shumë kohë, ndoshta i merr dy vjet, ndoshta tri vjet, ndoshta më tepër. Komisionet nuk i formon as Fondi, as "Partners Kosova", as Shoqëria civile. Çka po dëshirohet me këtë? Po dëshirohet që të krijohet një vetëdije, të mobilizohet shoqëria civile, jo vetëm e Kosovës por e krejt vendeve të rajonit në mënyrë që të mblidhen nëse shoqëria civile mobilizohet me një konsensus secili në vendin e vet, edhe në Kosovë, edhe shoqëria civile në Serbi dhe në Bosnje, në Kroaci dhe në Mal të Zi, ndoshta edhe në Maqedoni dhe atëherë shoqëria civile mbledh nënshkrimet dhe nëse mblidhen ato 1 milion nënshkrime sa janë paraparë në këtë proces, atëherë shoqëria civile në këtë rast e Kosovës i depoziton ato në Parlamentin e Kosovës dhe është Parlamenti i Kosovës ai që vendosë, po flas tash vetëm për Kosovën, ai që vendosë a me procesuar, a i nevojitet Kosovës me marrë pjesë në këtë komisionin rajonal, ky komision rajonal është unik në botë, ka plotë komisione

tjera por nuk ka komisione për shembull rajonale si ky i ish-Jugosllavisë ku prej një shteti dalin 5-6 shtete tjera. Domethënë është pak më kompleks, më i komplikuar dhe Kosova këtu në këtë rast ne deshëm apo s'deshëm duhet të jemi pjesë e kësaj për arsye se edhe po qe se formojmë komisionet nacionale, nëse kemi ende viktimat në Serbi, ne si komision nacional si do të shkojmë e t'i kërkojmë viktimat në Serbi dhe ti duhesh patjetër me bashkëpunuar me dikë. Nëse qeveritë nuk bashkëpunojnë dhe e kanë këtë status-kuo si kur që e kanë tash, atëherë patjetër ka me u nevojit shoqëria civile me u involvuar në këtë punë. Nuk ka ndonjë akter tjetër, nuk po e shoh. Për këtë arsye, kur flasim për komisionin, komisioni është diçka që ose ka me ndodh ose nuk ka me ndodh. Ne tash po flasim së pari për proces dhe mirë kishte me qenë që procesi të fillojë prej poshtë e jo me u konstruktuar, me ardhë prej jashtë, ose me ardhë prej shteteve të perëndimit ose prej donatorit. Mirë është ne ta krijojmë atë vetëdije dhe ta iniciojmë prej këtu brenda, ose me pa të nevojshme që ato viktimat që kanë rënë dhe ato 12.000 ose ato 2.000 viktimat që kanë mbetur pa u gjet ato kanë emra dhe mbiemra dhe për ato viktimat mos të flasim me numra. Ne nuk i dimë ku janë ato viktimat. Nëse janë në Beograd unë nuk shoh qysh tjetër me shku, ne po shohim qeveritë se nuk po bashkëpunojnë dhe kush ka me shkua e me i gjet ato viktimat atje. Domethënë, unë kisha me propozua që këtë rast komisioni mos të... sepse po krijon konfuzitet. Ne, as Natasha, as Shuki, askush nuk ka me krijuar këtë komision. Komisionet i formojnë qeveritë. Ne këtu po bashkëbisedojmë se si të mobilizohemi si segment i shoqërisë civile në mënyrë që të kontribuojmë për mbledhjen e këtyre nënshkrimeve për më vonë, për formim të komisionit. Nuk di sa jam e qartë, ju mundeni me më përmirësuar.

Eli Gashi: Nëse ka dikush prej artistëve, se pikërisht jemi mbledh t'i dëgjojmë artistët. Atëherë unë kisha me marr fjalën por kisha me inkurajuar edhe pjesëtarë të tjerë.

Atëherë, Nora faleminderit shumë për shpjegime. Po më duket se ka qenë shumë i nevojshëm. Në anën tjetër e kam theksuar edhe në disa takime tjera. Unë po e kuptoj brengën e Albertit por jo në kuptimin destruktiv të asaj që s'dojmë ne me marrë pjesë. Jo, unë po kuptoj, por ndoshta po gaboj. Po kuptoj në kuptimin se përveç tjerash kjo reflekton një perceptim. Perceptimi i këtij vendi për çështje të caktuara ose për rrjedha të caktuara politike që reflektojnë gjendjen e tanishme po edhe të kaluarën. Ne e dimë shumë mirë që e kaluara konstruktohet, e kaluara konstruktohet dhe sa më shumë kohë kalon ne e konstruktujmë të kaluarën në bazë të nevojave të tanishme. Ky është definicion se çka është kujtesa kolektive. Në kujtesën tonë kolektive është shqiptari – shiptar që e përmendi zotëri Pashoviq. Është e rëndësishme me u cek kjo për shkak se përderisa në atë periudhë të gjitha vendet në rajon kanë pasur një emër të qytetarit, emër me mbiemër, ka qenë emër e mbiemër për qytetar, shqiptarët në Kosovë kanë qenë shqiptar – që ka qenë, domethënë nuk ka qenë qytetari, nuk ka qenë identitet kombëtar, nuk ka qenë emër e mbiemër, por ka qenë punë, shiptar – ke me bartë. Kjo ka ngelë në kujtesën tonë kolektive. Tash cilat janë nevojat e tanishme. Ne e dimë qysh është përdorur kujtesa kolektive. E kemi shumë të freskët Betejën Kosovës dhe inxhinierimin politik që iu ka bërë betejës së Kosovës nëpërmes të së cilës pastaj janë ndërtuar plane shfarosëse...

Sarah Maliqi: Haris?

Haris Pashoviq: Unë mendoj se ky është një shqetësim shumë i ligjshëm, i Albertit dhe është shumë mirë që ai foli për atë dhe ai mua më lëvizi disa shumë mendime të rëndësishme për mua më duket, disa mendime të rëndësishme. Unë vetëm do të kisha

dashur diçka për të sqaruar pozicionin tim sepse mendoj se nuk është e qartë. Unë mendoj se Kosova ishte e pushtuar edhe para vitit 1989. Pra, unë kam shumë ... Vizioni im i okupacionit është më i lartë se kjo për të cilën fliste Alberti. Por e dini, ne dikur kemi bërë dhe ju këtë do të kuptoni sepse janë lloj shaka të cilat viktimat e kuptojnë. Ne dikur kemi bërë shaka me disa miq, për shembull, hebrenjve dhe kemi thënë, po ne tash nuk do të themi se gjenocidi i jonë është më i mirë. Dhe nuk ishte gjenocidi i juaj ëa i mirë se sa i joni, e dini. Shqiptarët nuk janë njerëz të veçantë. Shqiptarët ishin viktimë siç që ishin dhe myslimanët, siç janë kroatët dhe serbët ku ata ishin duke jetuar. Dhe unë mendoj se ky është fillimi i bisedës tonë, a është kështu. Unë mendoj se në qoftë se ne kemi bërë thirrje universale të të drejtave të njeriut në Kosovë të jetë e pavarur, që viktimat të janë të mbrojtura dhe ne tani nuk mund të ndalemi duke thirrur në drejtat e njeriut universale. Ne nuk mundemi në mënyre selektive të përdorim të drejtat të njeriut. Unë e kuptoj zhgënjimin i cili është tërësisht i justifikuar për se futbollistët kosovarë nuk mund të luajnë në Beograd. Unë mendoj se është e padrejtë. Por unë mendoj se është një mënyrë për të arritur deri tek loja në mes të ekipeve të Serbisë dhe Kosovës pikërisht është një iniciativë e tillë. Pikërisht kjo të dëgjohet, keni kujdes, unë përpiqem të jem i informuar, i cili lexoj raportet mbi shkeljet e të drejtave të njeriut, i cili përcill dhe jam i informuar, unë nuk e di sa duhet në lidhje me atë që ishte në Kosovë. Dhe unë jam në Sarajevë dhe do të thotë unë kam qasje në materialet dhe mediat dhe jam nuk jam i interesuar. Pra, si mund të presësh që një fshatar nga Shumadia të kuptoj atë që ishte në Kosovë, dhe si të dijë. Pra, mund të keni natyrisht ... Unë plotësisht ju kuptoj, frika se në një kontekst rajonal do të jetë minimizim. Kjo është një frikë në një kontekst rajonal, që krimi i cili ka ndodhur në Kosovë mund të minimizohet, të themi të relativizohet. Por gjithashtu, unë mendoj se këtu duhet kuptuar një frikë se në qoftë se komisioni të jetë vetëm i Kosovës se krimet që janë bërë, nuk e di, kundër serbëve njëjtë do të minimizohen. Të gjithë ne kemi ... në Bosnje thonë se nëse kjo do të shkoj në Bosnje perëndimore kroatët thonë pastaj thonë se myslimanët, eh ju do të minimizoni atë se çfarë ka ndodhur me ne. Nëse ju shkoni në Republikën Serpska, atëherë, e kuptoni, mendoj se gjithkund dikush është pakicë diku. Unë mendoj se në fakt vendi më prominent në Kosovë ekziston vetëm në kontekstin rajonal. Sepse këtë të cilën ju jeni duke e thënë, ne e dëgjojnë çdo ditë dhe çdo ditë e shohim në lajmet çdo ditë prej vitit 1996 për çdo ditë deri tek dita e sotme në lajmet i shohim raportet e zhvarrimit të varrezave masive. Fëmijët tanë janë duke u rritur, duke i shikuar varrezat masive. Amor Masoviç është kreu i Komisionit për zhvarrosjen, dhe unë pashë para shkollës filllore dy djem të cilët ishin 10 vjeçar dhe njëri e ngacmonte tjetrin dhe ky e ndiqte atë i zemëruar dhe i thoshte - në qoftë se të kapi as Amor Masoviç nuk do të njeh. Kuptoni! Pra, varrezat masive kanë depërtuar në lojën e fëmijëve. Kjo është e frikshme. E tani, ju njëjtë, si unë që nuk e di sa duhet në lidhje me Kosovën, ju nuk e dini sa duhet në lidhje me krimet në Bosnje. Dhe unë mendoj se kjo që Salem e tha është, ky shembull që nuk është unik që 20 shqiptarë janë të vrarë në Bijelini, dhe ajo që më tha Zana në pushim, kur më tha se në Gjakovë kanë qenë refugjatët nga Bosnja, gjatë luftës në Bosnje, këto janë arsytet se pse ne të gjithë duhet të dëgjojmë, dhe unë absolutisht pajtohem se kjo duhet të dëgjohet më së shumti në Beograd dhe unë mendoj se ne kemi bërë shumë që ky Komision vazhdimisht të shfaqet në të gjitha televizionet nacionale, në të gjitha këto vende, sepse kjo do të jetë e mjaftueshme. Ky një film, unë nuk kam pasur idenë se ai ishte në Marok. Unë me të vërtetë nuk e dija rreth kësaj asgjë deri sa nuk e pash. Dhe tani kjo do të mbetet për mua si një kujtim i rëndësishëm. Se

amerikanët aq thellë nuk i kanë kuptuarit drejtat e njeriut, ndoshta ne edhe sot ... ndoshta Kosova sot nuk do të ishte e pavarur. A mundem të pajtohem me këtë. E ata e kanë kuptuar në deklaratën e tyre të pavarësisë, e cila fillon " të gjithë burrat frikësohen." Bash për këtë Thomas Xheferson para 250 vite e shkruante në Deklaratën e pavarësisë së një shteti, Kosova sot mund të jetë e pavarur. Dhe kjo është ajo që do të doja të jemi në të, dhe për të shkuar së bashku në këtë drejtim. A keni bërë tani shqiptarë të Kosovës betejë. Mos lejoni që dikush për 600 vjet të vijë dhe të thotë - hej, ju para 600 viteve neve na keni... E them dhe unë nuk jam 600 vjet përpara se ju ose unë për ju, ju neve para 600 vite, dhe unë them unë nuk ju kam pasur juve para 600 vite, sepse as ty, as ti nuk ki ekzistuar para 600 vite. As unë nuk kam qenë para 600 vite. Ju që jeni viktimat e betejës të Kosovës - miti, një mit i ri dhe për të pasur një luftë të shqiptarëve të Kosovës që pastaj njerëz të tjerë do të jetë viktimat e tij. Në këtë unë shoh modernitetin e të menduarit e të drejtave të njeriut, dhe historinë dhe artin në Kosovë. Prandaj, ju jeni për mua më modern të mendoni se si të parandalojmë betejat e ardhshme në Kosovë. Amerikanët nuk do të shkojnë për të thënë asgjë. Por as Evropianët. Nuk dëshirojnë. E dini, thjesht jam duke u përpjekur t'u tregoj si ne i kemi ngritur zogjtë për ti fituar pulat. Se ne duhet për ti ushqyer për të pasur pula. E dini, ky është një iluzion mjaft i madh. Ju e dini, ky është një iluzion i madh. Në fillim, duket që amerikanët dhe evropianët do të qëndrojnë pas për dikë. Pas kësaj, ata nuk dëshirojnë. Ata do të qëndrojnë për veten e tyre. Ne kemi bashkëpunuar mirë me disa qeveri dhe organizata të ndryshme nga jashtë. Por pas një kohe njerëzit thonë mirë ju tani e keni pavarësinë, jeni të pavarur, dhe tash nuk ka më luftë, askush nuk ju rrah, gjendeni tash. Unë po shoh një ndjenjë pak kontradiktore nga ajo çka jam duke e dëgjuar këtu. Në të njëjtën kohë ne duam që Kosova të shkojë si ekip në Beograd për të luajtur kundër Serbisë por për zotin edhe nuk dëshirojmë. Ne duam të dinë se çfarë ka ndodhur, por nuk do t'u tregojmë. Unë mendoj se duhet të zgjidhet konflikti, ju e dini. Domethënë që duhet ...

Sarah Maliqi: Po, urdhëroni Zana!

Zana Hoxha Krasniqi: Jam Zana Hoxha Krasniqi, regjisore. Duke i dëgjuar të gjitha ato që u thanë po edhe filmi e bëri një efekt të vetin, mu sollën në mendje disa kontekste të asaj që dua të flas, por isha ndal më shumë si artiste, duke marrë parasysh se jemi mbledh sot me dëgjua këshilla ndoshta nga njëri-tjetri apo edhe rekomandimet si shumë të rëndësishme për punën e mëtutjeshme të KOMRA-s sepse besoj që gjithsesi do të themelohet. Unë kisha dhënë një kontribut timin duke marrë parasysh atë që unë e shoh se ka ndodhur një lloj largimi ose mospjesëmarrje të duhur të artistëve në procesin e të drejtave të njeriut apo në procesin e paraqitjes së krimeve dhe paraqitjes së asaj që ka ndodhë, në veçanti, në Kosovë, gjatë luftës. Ne jemi të vetëdijshëm e pas luftës ka pas një financim në shumicën e sferave në Kosovë nga donatorë të ndryshëm dhe shpesh ka ndodh që artistët që janë marrë me atë që ka ndodh gjatë luftës në Kosovë kanë tingëlluar ose arti i tyre ka shkuar drejt propagandës. Kjo ka qenë një prej atyre gjërave që ka dekurajuar artistët tjerë të merren me të vërtetën, të merren me atë që ka ndodhur gjatë luftës. Në veçanti kjo ka qenë shumë prezent në film dhe në teatër. Veprat që janë krijuar pas luftës, që kanë trajtuar fatin e njerëzve të zhdukur, fatin e personave të vrarë masovikisht apo dhunimet dhe depërtimet masive janë bërë në atë mënyrë që vetë ne, si shqiptarë, e kemi parë se dikush po mundohet me na shitë diçka. Unë e mbaj mend që pas filmit boshnjak që ka marrë Oskarin u ngritën disa debate në media te ne, te grupet e artistëve – pse ne s'po e bëjmë një film të këfillë. Dhe po ju tregoj diçka që kam menduar

qe një javë ditë. Me një shtypshkronjë ku unë shkova me i shtypur disa gjëra, më ra tri-katër herë dhe e ndjeva një punëtor duke folur serbisht, në shtypshkronjë shqiptare. Dhe thash mos po ndihet keq, sepse ne nuk kemi mësuar me i parë serbët e shqiptarët me punua bashkë pas luftës. Dhe, erdh punëtori që e ndjeva dhe nuk fliste më, vetëm ia la gjërat që i kishte prodhuar, që unë shkova me i marrë, në tavolinë dhe u largua. E pash pronarin se më shikoj sikur që unë kuptova diçka dhe nëse ajo kishte ndikuar që unë me ndryshuar sjelljen ndaj tij. Kjo është shumë e vërtetë. Ka ndodhur në javën e kaluar. Unë u ktheva në shtëpi dhe jam ende duke mendua se unë e kam kuptua me të vërtetë apo jo, apo ka ndodhur diçka tjetër dhe po mendoja tërë kohën se çka mund unë të bëj si artiste që kjo me u prezantua në formë artistike. Ende nuk e di se çka mundem me bë, po e di që kjo është ende diku në mua dhe gjithsesi do të merrem me të. Kisha vazhduar atë që thash më herët. Ka ekzistuar një dekurajim i artistëve për t'u marrë me luftën por edhe me pas luftën, sepse ka ndodhur një politizim. Mos të them shumica por disa prej artistëve që janë marrë me këtë fenomen kanë qenë të politizuar ose janë politizuar më vonë ose janë ende në politikë, kështu që vërtetë është dekurajuese për neve. Këtu prezent me ne janë disa artistë që janë marrë me fatin individual të njerëzve dhe atë që e kanë përjetuar ata gjatë dhjetë viteve, në veçanti edhe gjatë bombardimeve dhe pas bombardimeve. Unë isha ndal te kjo sepse mendoj që ne mund të përfitojmë shumë si artistë nga fatet individuale të viktimave, rrëfimet e tyre e unë vet jam marrë me dy-tri punë, me dy-tri shfaqje me viktimat dhe...

Albert Heta: Qysh me përfitua, çka me përfitua artistët prej fateve të viktimave, a mundesh me na sqarua këtë.

Zana Hoxha Krasniqi: Një të vërtet që nuk është e propaganduese, një të vërtetë se ne vetë kemi qenë viktimat.

(Ndërhyrje)

Zana Hoxha Krasniqi: Mirë, kërkoj falje nëse ka tingëlluar vrazhdë. Ndoshta për shkak të mënyrës se si u shpreha, u shpreha vrazhdë me atë fjalë specifikisht. Kur e pash dokumentarin, dua ta lidhi me atë, dhe dëgjova rrëfimet se cila ka pasur ndikim më të madh, ose ndikimi i rrëfimeve në komisionet ose në ato takimet rajonale ka qenë më i madh ndoshta se sa në kryeqytet apo në qendrat kryesore të Marokos, atë herë mu kujtua edhe mua se sa e rëndësishme është që të kthehemi në vendet e vogla të Kosovës ku kanë ndodhë krimet dhe shpesh mbesin vetëm propagandë ose njerëz të caktuar i përdorin kurdo që kanë nevojë. Më duhet të vazhdoj me atë që për mua personalisht, mos të flas në emër të shumicës, është shumë me rëndësi që njerëzit që merren me të drejtat e njeriut, ekspertët, aktivistët e vërtetë të më japin mundësi që të dëgjoj më shumë rreth të vërtetës, duke marrë atë si diçka që të tjerët po e ndajnë me neve, pa asnjë qëllim politik, pa asnjë qëllim të fshehur për të bërë diçka propagandistike. Ndoshta nuk isha shumë e qartë, mirëpo ju falënderoj për atë që më dhatë mundësinë të flas.

Shukrije Gashi: Faleminderit, Zana! Unë dëgjova me vëmendje edhe krejt atë që i thatë të gjithë ju, edhe Alberti dhe vërtet u ndjeva shumë keq. Aty ka shumë të vërteta. Të gjithë ne këtu që po i flasim është e vërtetë, janë perceptime individuale por janë të reflektuara nga gjendja aktuale dhe atë në të kaluarën.

Nëse duam të jemi të sinqertë, të përpiqemi të jemi të sinqertë, objektivë, duhet edhe ta vlerësojmë qartë situatën. E kuptoj edhe nevojën e popullatës shumicë të Kosovës për të

gjetur hapësirë, për të provuar, për ta qetësuar dhe shëruar qenien nacionale, për arsye se kjo asnjëherë s'ndodhi gjatë krejt historisë në këtë rajon. Ekzistojnë veçanti të cilat janë karakteristike. Nuk dua që ta politizoj por më duhet të flas se politizim është krejt çështja. Varet çfarë politikash ne do të udhëheqim në krijimin e një komisioni të tillë. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të rrethanave, fakteve, argumenteve. Në vitin 1981 krejt policia nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë morën pjesë në shkeljen me dhunë dhe zbrapjen me dhunë të protestuesve dhe ... shqiptarë. Dhe ndodhën arrestime të mëdha, ndodhën vrasje për të cilat nuk u fol kurrë. U fol në mënyrë sporadike tek-tuk, madje bile edhe udhëheqja e atëhershme e Kosovës u përpoq duke taktizuar me numra për të thënë diçka, por diçka që nuk do t'i dëmtonte. Ishte numri 7, 13 u vranë. Dhe kjo flet shumë. Po, ashtu! Dhe kjo flet shumë për padrejtësitë historike që janë bërë. Mirëpo, pikërisht pse atëherë nuk pat mundësi që të vendosej drejtësia për arsye se ne ishim të pafuqishëm dhe ishim të shtypur vazhdimisht. Nuk patë komisione të cilat do të merreshin me trajtimin e kësaj çështjeje, trajtimin e viktimave. Edhe atëherë kishte shumë të burgosur politikë. Dhe, një nga të burgosurit politik, më vjen keq që do ta marr vetveten si shembull, isha edhe unë dy vite më vonë. Dhe u shkelën të drejtat. Vazhduan në vazhdimësi të shkelen, në mënyrë masive deri tek masa u rrit pothuajse gjysma e popullatës të burgosur. Ishte vështirë në ato rrethana që për botën tjetër të Jugosllavisë, duke përfshirë Bosnjën që e përmendi më herët zotëria nga Bosnja, i nderuari Haris, që ta kuptonin se çka vërtet po ndodhte në Kosovë, çfarë kishte ndodhur në Kosovë. Për arsye se ishte një mbyllje e qëllimshme që nga fillimi, ishte bërë padrejtësi e madhe, përveç ndryshimeve që u bënë në Kushtetutën e vitit 1974. Edhe me atë Kushtetutë më shumë ishte një drejtësi e cila ishte vë në letër se sa në praktikë. Pastaj me ardhjen e Millosheviqit në fuqi dhe zhbërjen e autonomisë së Kosovës veç sa u vështirësuan dhe dëmtuan shumë edhe ashtu të drejtat nacionale dhe njerëzore në Kosovë. Megjithatë, ata që vërtetë janë aktivistë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk u zbrapsën me kaq, por vazhduan që edhe më tutje edhe në ato rrethana të bëjnë presion. Edhe ajo ishte një nismë, nismë minore, shumë e vogël. Por, megjithatë ishte një shkëndijë që diçka duhet të ndërmerrej. Dhe për nisma të tilla, po flas jo për nismën shqiptare, për arsye se nisma shqiptare vazhdoi edhe më tutje dhe herë-herë shumë e zëshme e herë-herë pak e zëshme, varësisht nga presionet që ndodhnin. Kuptohet se përfaqësuesit e popullit, të cilët nuk i zgjodhëm ne, ka qenë e pamundur që ata porositë, nevojat, kërkesat serioze të shqiptarëve t'i paraqesin në mënyrë të drejtë. Në mesin e tyre kishte të tillë të cilët u përpoqën realisht ta bënin këtë. Bile këtë rast do ta përmend të nderuarin dhe të ndjerin Fehmi Agani, e sot këtu me ne është biri i tij, bëri punë të madhe. Domethënë, këta ishin ata zëra të cilët e kishin kurajën që të bënin shumë, edhe pse kishin pak hapësirë. Dhe, natyrisht që Kosova, me të gjitha vështirësitë që i patë gjatë gjithë ekzistimit të saj, nuk e kishte fuqinë që ta bënte atë më të madhen – ta fitonte lirinë me forca të saj. Dhe u deshtë serish ndihma e bashkësisë ndërkombëtare. Në këtë ndihmë të bashkësisë ndërkombëtare, fatmirësisht po e them, gjithmonë patë miq qoftë edhe të paktë nga rajoni, të cilët u përpoqën që të përvidhen dhe të bëjnë diçka për të mirën e përgjithshme të rajonit në të ardhmen, në të sotmen dhe të nesërmen. Dhe të tillë ishin përfaqësuesit e shoqërisë civile, shoqatat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ata nuk ishin të shumtë, sepse edhe këta, bashkë me ne, jetonin në një regjim shtypës. Natyrisht se shtypja ishte më e madhe tek ne, për arsye se ne jetonim me vite të tëra në një regjim i cili nuk fliste me gjuhën të cilën e përdorte tek të tjerët. Është një fatkeqësi që u bënë padrejtësi të mëdha historike dhe nuk dua që të kthehem, domethënë

ishite Evropa ajo e cila nuk deshti t'i bënte korigjimet dhe u përpoq kësaj radhe, edhe pse me përpjekje jo objektive dhe në nivelin, shkallën të cilën ne e kemi prit. Ne të gjithë kemi shpresuar se pas përfundimit të luftës, Kosova do të jetë e pavarur, s'do të ketë rezolutë 1244, do të kryhen proceset shpejt, do ta marrim të drejtën për të cilën u përpoqëm me shekuj, mirëpo kjo është çështje e refleksioneve, e reflektimeve, e perceptimeve. Janë shumë shtete në botë dhe me përvoja të ndryshme kulturore, trashëgimore, tradicionale, me zhvillime të ndryshme të demokracisë dhe natyrisht nuk duhet pritur që njësoj të gjithë do ta kuptojnë edhe kontekstin e Kosovës. Absolutisht, jo! Aq më pak në rajon në të cilin jetojmë. Dhe tash, nga një regjim aq shtypës, të vijnë aktivistë të cilët gjejnë vullnet, dëshirë për të bërë sërish diçka për njerëzit në Kosovë, për viktimat, nuk duhet kuptuar këtë si tendencë në këtë rast tonin, po flas për miqtë që i kemi sot këtu, që përmes krijimit të një komisioni rajonal të tentohet të bëhet krijimi i një Jugosllavie të re. Assesi jo, sepse ne provuam që të bashkëjetonim, të jetojmë bashkë dhe kjo s'ndodhi. Nuk ndodhi pikërisht për shkak të qeverive shoviniste, nuk ndodhi, por rrethanat nuk janë të vendosura njëherë e përgjithmonë për të qenë të tilla. Dhe, falë përpjekjeve vetjake të cilat u lanë me gjak, dhe mund të madh dhe më vonë me përkrahjen e miqve dhe bashkësisë ndërkombëtare, e kur po them të miqve, po them për këta njerëz këtu, të djemve, të vajzave të Kosovës që ranë në luftën e fundit ne arritëm që të nxjerrim diçka. Unë pajtohem me Albertin kur tha – nuk është kryer lufta. Dhe, do ta përdori një slogan. Atë ditë që është shpall pavarësia dhe pash transparente “Bac u krye”, unë mendova se i thash Shukit – vetvetes “Bac, nuk është krye”. Kur thash nuk është krye, nuk mendova për luftën e armatosur, por mendova në procesin e gjatë të shërimit, të dëmshpërblimit, të kthimit të dinjitetit të atyre të cilët janë viktimizuar, të larjes së borxhit ndaj tyre, që e kemi, të krimit të rrethanave të favorshme për popujt tjerë të cilët jetojnë në Kosovë, jo veç shqiptarët. Atë frymën liridashëse që ne e kemi, tua bëjmë me dije se ne nuk jemi shtypës dhe atë që e përjetuam në lëkurën tonë dhe kurrizin tonë të mos e përjetojnë të tjerët. Në të gjitha këto, gjatë lëvizjeve, ju të gjithë e dini sa ishte ftoftë, e krejt kjo ngjarje më është sjell në kokë. Domethënë, përvojave të këqija duhet t'u jepet fundi dhe këto janë procese. Proceset zgjaten, por shkurtimit të proceseve do të mund t'iu ndihmojmë ne të cilët mendojmë ndryshe dhe konsiderojmë se mendojmë ndryshe dhe është një vetëdije më e lartë, në radhë të parë, po flas si krijues. Natyrisht se krijuesit janë qenie njerëzore dhe i kemi edhe subjektivizmit edhe objektivitetin. Pra, po them se ky është proces. Në këtë proces duhet gjetur vullnetin, dëshirën për të përkrahur iniciativat të cilat i ndihmojnë krijimit të rrethanave të favorshme paqësore në Kosovë e rajon dhe ne nuk jemi qeveri. Absolutisht komisionet i krijojnë qeveritë. Kjo tentativë e jona, ky koalicion, është vetëm një shprehje e vullnetit të aktivistëve të të drejtave njerëzore që tua bëjë me dije qytetarëve dhe të gjithë atyre që janë të vullnetit të mirë se kjo është vetëm edhe një mundësi që proceset të ecin tutje, që të zgjohen ndërgjegjet e qeverive për ta dënuar të kaluarën e dëmshme, për ta vënë drejtësinë në vend dhe për t'i lënë diçka më të mirë, shpresa më të mëdha dhe më të mira gjeneratave që vijnë. Unë kaq kisha për të thënë. Ju falënderoj shumë për këtë pjesëmarrje tuajën. Do të dëshiroja që të ishte më masive, por ja dëshirat dhe mundësitë janë tjera. Faleminderit!

Sarah Maliqi: Faleminderit! Unë nuk kam për të shtuar asgjë, sepse biseduam me Shukin dhe jemi kah përfundimi. E ka fjalën Petriti.

Petrit Çarkaxhiu: Unë jam Petrit Çarkaxhiu. Në program po thotë – konsultim me artistë kosovarë për themelimin e komisionit rajonal për caktim të fakteve që pak a

shumë, po them, në parim jam i pajtimit me u bë një gjë e tillë, por kontributi ynë kishte me qenë më tepër në rolin e promovuesve. Të dy ose tri prezantimet, të Harisit – Haris Pashoviqit kishin të bëjnë më tepër me thyerjen e paragjykimeve, sidomos të atij emrit, stereotipit të nosaçait – të shqiptarit. Edhe mua po më doket se shumë më tepër kishte me qenë aty roli i artistëve se sa në themelimin e një komisioni. Nëse po e kuptoj drejt dhe nëse është kjo poenta e krijimit ose të kësaj iniciative, unë mundem me thënë se prej eksperiencës time personale, sidomos me punën në rrjetin e radiostacioneve dhe organizatave të ish-Jugosllavisë, që quhet “kros radio”. Pra, njëra prej qëllimeve kryesore të krijimit të atij rrjeti ka qenë kjo thyerja e barrierave në mes të popujve, thyerja e paragjykimeve që në të ardhmen, domethënë, përmes kësaj mos me ardhë deri te ajo çka ka ndodhur në vitet e kaluara. Mirëpo, prapëseprapë rasti i shqiptarëve në ish-Jugosllavi është një rast specifik. Domethënë, më kujtohet prej herës së kaluar kur kam qenë në Beograd, po më tregojnë për një anketë e cila është mbajtur me studentët e Beogradit, në të cilën kanë pyetur se me kë kishit pasur qejf me kanë cimer. Domethënë, këtë e kanë bërë pyetje studentët e Universitetit të Beogradit. Dhe të parët në listë kanë qenë shqiptarët, të dytët në listë kanë qenë romët dhe të tretit kanë qenë, pastaj kroatët. Domethënë jo po flet për një Brain Wash shumë të madh, për një paragjykim, për një propagandë që i ka rrënjët bajagi si të thella dhe vetë fakti që e përmendi edhe Alberti, po edhe Harisi dhe Harisi u nis prej parimit universal se krejt viktimat janë të njëjta, po edhe unë pajtohem se krejt viktimat janë të njëjta në atë aspekt. Mirëpo, prej vetë kësaj ankete ose prej vetë faktit që paragjykimet për shqiptarët në ish-Jugosllavi i kanë rrënjët bajagi si më të thella, domethënë edhe për ta thyer atë paragjykim të vyen një kohë shumë më e madhe dhe fatkeqësisht nuk mund t’i qesim në një nivel të njëjtë. Mua po më vjen mirë që po thotë këtu – themelimi i komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve dhe tjera e tjera, mos t’i përmend tash, të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi. Ok, në ish-Jugosllavi! Jugosllavia në 45-tën, më herët mbretëria – Jugosllavia si pasuese e mbretërisë serbo-kroato-slllovene... Nëse ishte bërë një mbledhje e fakteve për krime të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi që s’po caktohet, domethënë nuk po tregohet koha, nuk është e limituar, atëherë patjetër nëse duam me thye këtë stereotip, dhe unë po nisem prej asaj prej meje, domethënë si shqiptar, atëherë duhet me nis me i mbledh faktet prej fillimit. Duhet me nis me i përmend faktet prej çka ka ndodhë, nëse të paktën po dojmë me edukuar të vërtetën pjesëtarët e nacionaliteteve tjera që kanë jetuar në ish-Jugosllavi si serbët, kroatët, boshnjakët, sepse ky paragjykim nuk vlen vetëm për serbët por edhe për popujt tjerë. Domethënë të njëjtin paragjykim e kanë edhe tjerët. Nëse duam me thye atë, atëherë duhet t’i prezantojmë të gjitha faktet se çka ka ndodhë prej të 12-ës, luftës së parë botërore, luftës së dytë botërore, çka ka ndodhë menjëherë pas luftës së dytë botërore, çka ka ndodhur në kohën e Rankoviqit, çka ka ndodhë në 60-at derisa kemi marrë Universitetin, çka ka ndodhë deri në 74-ën, 81-shin, 89-ën, 99-ën e krejt këtë periudhë sepse krejt kjo periudhë është periudhë e shkeljeve të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi. Të paktën Jugosllavia ekziston prej asaj kohe. Dhe, ok, le t’i mbledhin faktet jo vetëm për shqiptarë, por krejt ku ka pasur shkelje të të drejtave dhe me siguri kemi me pa se ka disbalancë, por kjo është e vërteta dhe të vërtetën duhet me thënë. Njëpërmjet “kros radios” deri diku kemi mbërri me i thye paragjykimet se për herë të parë këta njerëz që domethënë i kanë përfaqësuar radiot prej Lubjanës, Mariborit, Beogradit, Novi-Sadit, Sarajevës, Mostarit, Banja-Llukës, Shkupit, domethënë ata njerëz herën e parë, domethënë në emisionin e parë që kemi prodhuar ne për një bend të këtuhit, kanë

qenë të shokuar, të shokuar në aspektin pozitiv të fjalës po flas. Bile, është fjala për prezantimin e një grupi “retrovizor” dhe në fund të vitit pasi është bërë një garë se kush do ta fitojë vendin e parë – hitin, domethënë vendin e parë në top-listën e artistëve të ish-Ballkanit, vendin e parë e fiton “retrovizorja”. Domethënë atë edhe vetë ma kanë pranuar, për shembull, përfaqësuesit e “kros radios” prej Beogradit që kanë qenë të shokuar.

Rasti tjetër është pjesëmarrja ime në një takim në Beograd me anëtarët e “kros radios” si dhe prezantimi i filmit për rok skenën e Kosovës, domethënë kur është shfaqur në një kinema të Beogradit. Bile më duket edhe Natasha ka qenë prezentë aty. Ne kemi mbërrirë te një numër i vogël i njerëzve, domethënë me depërtuar. Paragjykimet janë aq të mëdha sa që, për shembull, kur e kam dorëzuar një CD me kompilacion me këngët e rok skenës së Kosovës, një pronari të një klubi në Beograd ai ka thënë – këqyr, po më vjen keq po unë krejt çka kam ditë për Kosovë është që atje janë do njerëz me do kapuçta të bardhë dhe me do vallëzime tradicionale. Domethënë ai ka qenë shumë i interesuar se do me thënë atje po ndodhka diçka. Ose reagimi tjetër i një regjisori serb që jetonte në Nju – Jork, tha krejt këta njerëzit që folën në film, domethënë të intervistuarit – anëtarë të bendeve, krejt tha ishin do njerëz inteligjentë. Domethënë, kjo po tregon me sa paragjykime janë këta, qysh janë rritë. Unë s’po i fajësoj ata por po e fajësoj kulturën e cila ekziston, domethënë në familjet e tyre. Dhe nuk mundet ky paragjykim me u kalua, me u heq nëse kjo është të paktën poenta dhe nëse s’po duam me u përsëritë luftërat më, nuk mundet me mbledhje të fakteve vetëm çka ka ndodhë prej 98-ës, ose veç çka ka ndodhur prej 89-ës. Kjo shkon shumë-shumë më herët. Shumë herët dhe duhet me ua shpjegua të gjithëve. Duhet me iu tregua dhe me ua heq atë se unë e kam dëgjuar prej serbëve që fëmijës i kanë thënë në djep – bir e flej se vjen shqiptari. Ose sikur neve që na thonë bjer e flej se vjen baba rroga. Kjo do me thënë është, të paktën si unë po e shoh, shumë serioze kjo punë nëse duam ta mbërrijmë këtë. Në anë tjetër, normal se kemi edhe ne çka me thënë këtu në Kosovë sa i përket rasteve me komunitetin serb. Mirëpo, nëse unë si artist dua të flas për një rast i cili më ka shokuar që e kam marrë vesh tek tash para dhjetë vjetëve, që në lagjen time ka jetuar një serbe, e cila gjatë luftës i ka mbrojtur disa familje shqiptare, i ka ruajt, ua ka ruajt banesat e tyre, i ka marrë në shtëpinë e vet dhe pas luftës këtë serbe e vrasin shqiptarët për me ia marrë banesën. Për mua ka qenë, thjesht shohim dhe këtë e kam dëgjuar prej prindërve të mi. Ose rastin, që e tregon edhe vetë Flora Brovina kur ka qenë në momentin para ekzekutimit prej policëve e ka shpëtuar një plakë serbe. Edhe ky paragjykimi ynë, edhe pse nuk është paragjykim sepse ne jemi krejt të djegtë prej kësaj lufte, por prapëseprapë janë raste se sa shumë kanë bërë për t’u treguar e vërteta prej zonjës Kandiq, prej zonjës Biserko e tjera. Janë raste të cilat duhet të cekem dhe unë jam për këtë. Mirëpo, të them, për me pas fytyrë e me dal para kushërirës time në Gjakovë që ia kanë vra djalin dhe burrin, e me i thënë asaj ose me bë një film dokumentar, një këngë ose diçka që flet për rastin e kësaj serbes në lagjen time që e kanë vra, unë duhet së pari me arsyetuar veten me atë që kam bërë mjaft për familjen e saj ose për rastin e saj konkret. Domethënë, atëherë kam alibi që të dal ashtu si duhet para saj dhe para pjesës tjetër. Mirëpo, së pari ne kemi problem vetë me qeverinë tonë. Këtë krejt po e shohim se roli ynë ka me qenë i atyre që kanë me bë presion në media. OK. Presioni në media me siguri ka me qenë më i fuqishëm kur në mënyrë të koordinuar për të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë mbahen aktivitete për një periudhë kohore që do të flitet për punën e krimeve të luftës, për të zhdukurit e tjera, e tjera. Prandaj, unë prapë, po nisem prej eksperiencës personale. Bendi ynë për shembull e ka bërë një video-klip për të

zhdukurit dhe i është dedikuar familjarëve të zhdukur në Kosovë dhe ajo ka pasur impaktin e vet te njerëzit. Nëpër forume kam parë duke folur, domethënë kanë diskutuar shumë. Mirëpo, që thotë një fjalë serbe “svaka čuda tri dana traje” dhe tash të mos mbetet ajo veç me një presion publik që dolëm folëm ne dhe hyri në njërën vesh e dual në veshin tjetër. Unë nuk mund të pres as prej Qeverisë së Kosovës, as prej Qeverisë së Serbisë dhe as të Bosnjës se kanë me qenë ato qeveri të ndërgjegjshme që kur t’ju dorëzohet atyre një peticion me nënshkrime ata do të thonë valla ne tash po e nënshkruajmë këtë dhe kemi me themeluar këtë. Unë, më shumë po shoh se presioni mediatik duhet me u bë, në mënyrë që të ngritet vetëdija e opinionit por në anën tjetër po më duket se më shumë target kishte me qenë komuniteti evropian ose zyrja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat duhet të bëjnë presion përmbi qeveritë tona për të themeluar një komision të tillë. Sepse, fundi i fundit, duhet me i thënë s’ti jap këto fonde ose diçka tjetër, me i prekë në parë, sepse vetëm aty prekën ata. Nejse, tash ide kemi sa të duash, por “pula a kemi” dhe s’po di a e dinë këta këtë vic, por ua tregojmë pastaj, në fund. A ka nevojë me tregua apo jo? Ok, mendoj se duhet me ua shpjegu. Shkon njëri te një hoxhë dhe i thotë, hoxhë po më cofin pulat. U mbytën duke më cofur pulat. Thotë po a. Ky i thotë çka me bë? Valla, provo qitju ujë të ftoftë, akull. Ai iu qet ujë të ftoftë, por kurgjo. Shkon ai prapë dhe e i thotë, valla po më cofin pulat prapë. A din çka, thotë, provo me ujë të nxehtë, valë. Shkon e provon, por prapë po i cofin pulat. Thotë ky, hoxhë prapë po më cofin pulat, i qita ujë të ftoftë dhe të nxehtë por po më cofin pulat. Thotë a ki ndonjë ide tjetër? Thotë, ide sa të duash, por pula a ki ti. E tash, ne si artistë, ide kemi boll, sa të duash me killë, por pulat na vyejnë, mundësisht. Nejse, prapë po i kthehemi realitetit të hidhur. Unë isha nis për një rast banal që përmendet. Paramendoni, ne e kemi një “Aushvic” në Kosovë. Ne nuk e kemi të nivelit të Aushvicit, por një vend në të cilin është zhvilluar një masakër e madhe. Është burgu i Dubravës. Edhe ai burg i Dubravës, në vend që të jetë si një muze ku tregohet se çfarë krimi u bë në atë vend, aty, në të njëjtin vend shtihen ata njerëz që janë kanë në luftë, a çka po di unë. S’po di tash unë me hy brenda. Aha, kanë me renovu, pra. Aty ka aq histori të madhe, në atë burg të Dubravës sa që është budallaki dhe janë budallaki tona, s’po ia lë fajin askujt. Mirëpo, për me mbërri këtë impakt që po duam me mbërri te krejt shtetet dhe krejt vendet e ish-Jugosllavisë, atëherë si me thënë, veprimi i këtij komisioni ose veprimi i kësaj iniciative duhet të jetë, po më vjen keq që po shprehem kështu, por duhet të jetë pak më i dhunshëm, duhet me kanë si në rastin e Gjermanisë. Domethënë, menjëherë pas Luftës së dytë botërore, kur i kanë shti me zor krejt popullatën me shkua në Aushvic dhe me pa se çka u kanë bërë hebrenjve. Pra, si obligim, me pa se çka ka ndodhur aty. Pastaj edhe me tekste shkollore, domethënë prej fillimit me iu treguar se çka ka ndodhur vërtet në histori. Këto janë sende që bëhen me vendimin e qeverive. Dhe për këto vendime, nëse ne mund të bëjmë presion te evropianët dhe amerikanët që me i shti këta me bë diçka. Dhe prapë po e them, sepse pa shkua, kjo Tina dhe pa thënë ajo ti duhet me bë këtë e ai s’e bën. Ose Tadiqit me i thënë valla s’ti jap paret, s’ti lëshoj vizat për Evropë dhe s’ke qare pa e bë këtë, ai atëherë do ta bëjë. Kështu që kështu bëhet kjo. Unë jam pak për hapat më radikalë.

Haris Pashoviq: Amerikanët nuk do të shkojnë për të thonë asgjë. Or as Evropianet. Nuk dëshirojnë. E dini, thjesht jam duke u përpjekur t’u tregoj si ne i kemi ngritur zogjtë për ti fituar pulat. Se ne duhet për ti ushqejmë për të pasur pula. E dini, ky është një iluzion mjaft i madh. Ju e dini, ky është një iluzion i madh. Në fillim, duket që amerikanët dhe evropianët do të qëndrojnë pas për dikën. Pas kësaj, ata nuk dëshirojnë. Ata do të

qëndrojnë për veten e tyre. Ne kemi bashkëpunuar mirë me disa qeveri dhe organizata të ndryshme nga jashtë. Por pas një kohe njerëzit thonë mirë ju tani e keni pavarësinë, jeni të pavarur, dhe tash nuk ka më luftë, askush nuk ju rrah, gjendeni tash. Unë po shoh një ndjenjë pak kontradiktore nga ajo çka jam duke e dëgjuar këtu. Në të njëjtën kohë ne duam që Kosova të shkojë si ekip në Beogradit për të luajtur kundër Serbisë por për zotin edhe nuk dëshirojmë. Ne duam të dinë se çfarë ka ndodhur, por nuk do t'u tregojmë. Unë mendoj se duhet të zgjidhet konflikti, ju e dini. Domethënë që duhet ...

Eli Krasniqi: Unë deri tash nuk pash asnjë reagim kundër. Nuk po di dhe në fakt nuk jam shumë e sigurt kemi kuptimin e njëjtë. Deri tash unë nuk dëgjova askënd që është kundër çfarëdo iniciative, sidomos të kësaj iniciative. Unë mendoj se në parim të gjithë u pajtuan se duhet, bile Petriti e ilustroi edhe shumë bukur. Unë mendoj se e vetmja çështje është te përfaqësimi ndoshta i Kosovës, kjo është çka unë dëgjova dhe ky është perceptimi im për atë se çka kam dëgjuar deri tash, jo domosdoshmërisht mendimi im. E vetmja është që t'i shtohet kësaj iniciative njëfarë përfaqësimi i Kosovës që është më i plotë. Çka do me thënë më i plotë? Është që ndoshta në mesin e organizatave të koalicionit me figuruar edhe Kosova për shkak të ndjesisë që Kosova tash është e pavarur, është shtet dhe mundet ajo vetë me fol për veten.

Haris Pashoviq: Unë mendoj që figuron.

Eli Krasniqi: Ju lutem, mos ndërhyni ashtu të gjithë, se nuk po mund të ju përcjell. Po dua vetëm një gjë ta bëj të qartë. S'po kuptoj, në koalicion janë organizatat prej Kosovës: "Partners Kosvova", Nisma ... për të drejtat e njeriut, Integra, CBM dhe plotë të tjera të cilat janë pjesë e koalicionit dhe nuk po di, nuk ka pjesë të koalicionit me numra dhe mendoj ne s'mundemi me i mbajt me numra, janë dy organizata prej Kosovës e 5 prej Serbisë. Po mendoj se po duket i kemi tejkaluar atë gjitha ato llojet e matjeve por në koalicion janë organizatat të cilat mendojnë dhe kanë menduar dhe kanë vendos për të hyrë me përkrah këtë iniciativë. Më falni, ndoshta më duhet pak të ndërhyj sepse kam shuajt deri tash por jo parimisht për t'i thyer paragjykimet e stereotipat, aty i bëjmë në mënyra të ndryshme tjera. Mirëpo, me një qëllim e ai është e vërteta që ka ndodhë, me i përkrah ose vënia e drejtësisë për viktimat, duke krijuar një platformë për viktimat ku do të dëshmojnë. Unë nuk e shoh, po mendoj personalisht, ne mundemi edhe këtu me thënë se kurgjo s'po bëhet dhe as që ka dëshirë me u bë mirëpo kur diçka që ka ndodh ne mundemi me matë atë me gjykimet e krimeve të luftës që janë duke u bërë në Beograd me rastin e Suharekës e tjerë, sepse kur flet atje viktimat, kur dëshmon atje viktimat qysh perceptohet dhe dokumentohet, faktikisht. Domethënë keni fakte. Ajo është diçka që bie. Sa i përket procesit, po më duket ndoshta Nora e tha pak më me shumë informata, por ky është një proces i konsultimeve por në cilën kohë, qysh ka me qenë mandati. Ajo do të shkojë më vonë. Domethënë ne nuk kemi pasur diskutime. A jeni ulur ndonjëherë me folë për këtë çfarëdo komisioni. Është hera e parë. Nuk ka diskutime dhe kjo është që ajo duhet të bëhet jo vetëm në Kosovë por në të gjithë rajonin dhe të bisedojmë e flasim dhe të shohim cilat janë ato nevojat dhe pritjet tona me një qëllim drejtësia për viktimat. Po mendoj se kështu unë e shoh personalisht, pastaj edhe si organizatë. Më falni që unë ndërhyra. Tash e ka radhën Ilir Bajra.

ILIR BAJRI: Më në fund u bë situata ashtu, Petriti e ndezi pak situatën dhe filluat me qeshë dhe fillova me u frikës ngadalë, ishte serioz. Natyrisht secili prej neve ka

eksperiencë personale sa i përket shkeljes së të drejtave të njeriut dhe ai është gjithmonë burim i fortë për të konstatuar ose me shpenzua më shumë minuta se që ka nevojë.

Por, po dua të ndalem, sepse diçka s'e kam të qartë, se kam të qartë qëllimin. Deri diku po shpjegohet se qëllimi është i qartë – Drejtësia për viktimat. Domethënë ky është funksioni i komisionit. A është funksion i komisionit vetëm drejtësia për viktimat apo është krijimi i kushteve për ngritjen e përmirësimit të gjendjes në ... qysh me thënë, domethënë krijimi i një... që artistët nuk kanë problem fare por që thirrret utopi krijimi i një shoqërie ku të drejtat e njeriut nuk kanë nevojë të ekzistojnë sepse aty janë të natyrshme dhe janë normale. Secili prej nesh, natyrisht shumë lehtë mbërrin në këtë konstatim, por e vërteta është se kjo nuk po funksionon. E drejta universale dhe qëllimisht thirrret universale për shkak se nuk mund të shikohet ashtu siç po e shoh unë që po diskutohet edhe këtu, nuk mundet të shikohet parciaisht në Kosovë, Serbi, Evropë por është universale, është e drejtë humane. Natyrisht ne duhet të kujdesemi për shtëpinë tonë por ndoshta kjo është karakteristikë e artistëve edhe pse kjo më parë nuk është profesion por është thjeshtë një situatë shumë komode. Besoj se artistët e kanë një utopi, edhe unë e kam, ku ta bëj një analogji, sepse mu duket interesant konsultimi me artistë kosovarë mbi themelimin e komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve. Mua më ka tingëllur gati si me thirrë balerinat me luajt futboll. A dini, po tregoj sinqerisht. Nuk është ide e keqe, por futbollit është lojë e baleti është vallëzim. Po e përdori këtë analogji se mendoj që e njëjta analogji vlen për... analogjia është e njëjtë në kuptimin e proporcionit në mes të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të njerëzve që luftojnë për të drejtat e njeriut jo vetëm në rajonin tonë por në përgjithësi. Mendoj se qëllimi përveç mbrojtjes të drejtave të viktimave se mua fjalët se të gjitha viktimat janë të barabarta më frikojnë, a dini, në kontekst historik tingëllon, sepse shumë shpesh kemi dëgjuar këso formulime dhe gjithmonë konotacioni ka qenë një rundë. Unë mendoj që duhet përveç mbrojtjes së të drejtave të viktimave na duhet me ngrit edhe në nivel më të lartë, ne duhet të shikojmë si duhet me rregullu këtë problem, qysh mos me pas më shkelje të drejtave të njeriut. Natyrisht kjo mundet me tingëllues utopike por qëllimi ishte dashur të jetë ai, domethënë komisioni me i mbrojt të drejtat e viktimave por në të njëjtën kohë me krijuar edhe një nën komision i cili kishte me identifikuar ato vegla të cilat kishin me ndihmuar që shoqëria të edukohet në frymën e të drejtës së njeriut. Domethënë mos me pas më nevojë ne me nga pas viktimave por me gjet thelbin dhe me ia nis me punua prej tani në gjetjen e zgjidhjes për këtë problem. Shikoni, e drejta universale po bëhet 60 vjet se është nënshkruar. A po? Po, po – konventa. Në këto 60 vjet, industria e kompjuterëve ka përparuar hatashëm e ne kemi dështuar, po flas në përgjithësi – ne, domethënë civilizimi ynë i bukur, dështuar për 60 vjet me shti në funksion diçka që është shumë e logjikshme për secilin prej nesh. Por, nuk është kah funksionon. Mendoj që ndoshta duhet që të drejtat e njeriut me i lëvizë prej një pozicioni të njëfarë komoditeti, të njëfarë ... Domethënë si shpërblim, si privilegj, por me fut në domenin e interesit për shkak se si interes mundet edhe me funksionuar. Domethënë nëse ne mbërrimë, po e di që tingëllon utopike, por nëse ne mbërrimë që në shoqëri dhe në edukim me fut një mentalitet dhe me edukuar më parë, domethënë më parë me i edukuar se me i bind që të drejtat universale, të drejtat e njeriut janë të mira, por thjeshtë me i edukuar dhe ata me pa si të natyrshme, ne kemi me arrit në një situatë kur kemi me mund me thënë me 100% siguri siç tha zonja Natasha Kandiç që luftë s'ka me pas më këtu. Shpresoj pra jashtëzakonisht se nuk ka me pas luftë.! Pra, vetëm ta përfundoj me atë analogjinë e futbollit. Unë kisha pasur qejf që

në një moment me pa një futboll ku në vend të lojtarëve kanë me luajt balerinat me top dhe s'ka me pas kurrfarë rezultati, por njerëzit kanë me vallëzua dhe njerëzit kanë me u kënaq me vallëzim më përpara se me luajt.

Sarah Maliqi: Faleminderit, Ilir! Veç pak, se u lajmërua Hakia që sa, por edhe e anashkaluam pak, e pastaj ti Albert.

Haki Abazi: Në fakt edhe unë po nisem prej qëndrimit të Elit që unë duhet me kanë shumë i shkurtër, sepse është konsultim për artistë të Kosovës dhe po mendoj se nganjëherë po keqkuptohet se ju jeni veç një grup i shoqërisë kosovare, prej të cilëve është kërkuar mendim, analizë prej këndit tuaj lidhur me procesin për gjetjen e fakteve. Dhe, këtu qëndron pësia e përgjegjësisë, barra e kujtesës individuale edhe të një grupi shoqëror shumë të rëndësishëm, jashtëzakonisht të rëndësishëm për një proces i cili po parashihet në nivel të regjionit. Unë po them, duke pasur parasysh që debati në përgjithësi në Kosovë është shumë i varfër. Ju e dini si grup shoqëror sa jeni të lënë anash prej vendimmarrësve, prej njerëzve të cilët duhet me ju konsultuar edhe për gjëra tjera, jo veç për të kaluarën, sa jeni lënë anash, pjesërisht për fajin tuaj sepse nuk jeni shumë kompaktë dhe ju vetë nuk organizoni debate të niveleve të ndryshme qoftë për vlerat qoftë për zhvillimet në Kosovë, por kjo po e tregon edhe arsyen pse debati ndoshta shpeshherë po del prej strukturave për temën për të cilën jemi duke biseduar sot. Mirëpo, megjithatë, ky është send pozitiv. Është send pozitiv për shkak se është fillimi i një procesi kur ne, po them ne sepse po e konsideroj veten kosovar shqiptar, po flasim për një çështje, por jemi pjesë e një debati i cili është shumë i rëndësishëm, përderisa sot asnjëherë nuk jemi thirr për të dhënë mendimin tonë se çka në të vërtetë dhe si do të duhej dukur procesi për këto çështje. Unë e di që ne jemi të ngarkuar me mungesë debati, jemi të ngarkuar me shumë fakte, jemi ngarkuar me shumë njohuri që i kemi prej të kaluarës, prej atyre qysh na u kanë interpretuar por një send është shumë i rëndësishëm për t'u kuptuar se jam në të njëjtën situatë kur ballafaqohemi me serbë, ballafaqohem me maqedon, me kroatë, me sllovenë, me evropianë që kanë paragjykime. Por nuk është detyrë e jonë gjithmonë të mundohemi me ia thye paragjykimet të tjerëve. Hajde të veprojmë brenda kornizave tona në kuptimin që kush jemi ne të punojmë për veten. Ajo ka me reflektua pastaj në regjion. Format qysh reprezentohet Kosova me kulturën, me politikën e saj, me të gjitha ato ka me bë që tjerët me ndërrua qëndrim. Nëse ne vazhdojmë tërë kohën duke menduar se çfarë paragjykime tjerët kanë për neve, është gati si pothuaj harxhim i energjisë që nuk kemi nevojë me bë. Më besoni. Të krijojmë secili në fushën në të cilën jemi e ju si artistë në fushën tuaj e pastaj ajo le të jetë ambasadori që do të krijojë impaktin për ndryshim të paragjykimeve. Veç po e ndaj një storie që ndodhi para 3 dite, në fakt 5, jo 3, duke shkuar për Mal të Zi në Kollashin i mora 3 vetë në kerr, që ishin duke shkuar për Podgoricë dhe 2 prej vajzave ishin serbe prej Kollashinit. Hera e parë që kishin kontaktuar ndonjëherë me një shqiptar. Hera e parë! Dhe thanë se bindja e tyre prej këngëve është se diku një arbanas në Graçanicë ia paska nxjerrë sytë dikujt. Është fakt se nuk ki kurgjo ma shumë se sa me u ndal me marrë dikë me kerr dhe me zhvillua një bashkëbisedim, që është plotësisht natyrore. Paragjykimet janë por hajde të ecim përpara. Po ka paragjykime, kanë ndodhë këto sende, e vërteta është që ne duhet të pyesim si individ, si kolektivitet çfarë forme kemi me mund me i ndërru këto paragjykime por pa i vënë në fokus, por duke vënë në fokus veten, krijimtarinë tonë, artikullimin tonë për të mund me i kontribuar vlerave njerëzore në rrethin ku jetojmë, që

kemi problem jashtëzakonisht të madh, edhe një herë po them e mandej përtej kufijve të këtij shteti të Kosovës. Faleminderit!

Sarah Maliqi: Eli, ju lutem, veç pak! Po shoh se Alberti paraqitet, kurse Bekimi pastaj.

Albert Heta: Po e shoh vazhdimisht veten të thirrur dhe po e ndiej veten të çuditshëm tash. Kështu, unë nuk desha me thirr ndonjë farë vetëdije kombëtare këtu kur thash diçka, përkundrazi. Kur e kam pranuar ftesën prej Sarës, definitivisht besoj se ka potencial kjo shoqëri me krijua një komision të tillë dhe për këtë jam duke fol, shumicën e kohës. Nuk kam kurgjo kundër aspak dhe kur e përmenda komisionin e Kosovës gjithmonë thash se kishte me koordinuar me komisionin në nivel rajonal. Përkundrazi, unë po besoj se Petriti në këtë rast, nuk besoj që paragjykimet kanë qenë shkak i luftës, aspak. Unë mendoj se arsyet kanë qenë tjera. Paragjykimet funksionojnë edhe në nivel të kësaj tavoline. Për shembull paragjykohen artistë që nuk mund ta kuptojnë draft dokumentin për këtë konferencë dhe i thonë Spaiçe shatell, a po di, thjeshtë. Por, problemet janë shumë më të thella se sa këto të vogla që unë ndoshta i përmenda. Po tash me u kthye në konstruksionin e krijimit të historisë në të cilin është punuar. Për shembull Kosova, unë besoj ka qenë rasti i vetëm, e nuk po dua me tingëllu pro qeveritar apo pro kombëtar në të cilin janë revidu tekstet e historisë. Në tekste të historisë në bashkëpunim me komisionin evropian apo nuk e di, organizma tjerë, janë larguar fjalët “okupatorë”, janë larguar fjalët të cilat e kanë bërë njëfarë pozicionimi politik të luftës. Do të thotë, ka pasur intervenim në tekstet e historisë. Ka edhe raste tjera nëpërmes të cilave kjo shoqëri ka kaluar ose është shty të kalojë nëpër njëfarë procesi të normalizimit. Ky proces natyrisht nuk i ka përfshirë të gjitha vendet, i ka përfshirë fatkeqësisht në rastin e luftërave të Jugosllavisë vendet të cilat kanë qenë viktima më të mëdha të luftërave, sepse aty ka pasur administrim të jashtëm, i cili e ka futur vendin nëpër atë proces. Tjetra. Kosova sot s’ka lidhje me kurgjo shqiptare. E projektuar në imazh është shtet i qytetarëve të Kosovës me gjashtë yje të cilat simbolizojnë gjashtë komunitete në Kosovë, kështu që pas 600 vjetëve ne as që kemi me mbajt në mend që jemi shqiptarë. A e dini, thjeshtë, në këtë rrafsh po dua me bisedua. Ndarja në mes projektit shqiptar për bashkim me Shqipërinë apo me qenë shqiptar ka ndodhur në 1989 dhe sot jemi në një realitet të projektuar krejtësisht tjetër. Kur manipulohet me këto fjalë tregohet se hapësira e ish-Jugosllavisë ende qëndron në paragjykimet e tyre për çka është Kosova, edhe sot kur më nuk është as ajo që është projektuar dikur. Puna, të themi, në individualizimin e viktimave, është një punë që sigurisht do të bëhet, nuk ka fjalë, por unë vetëm desha përveç se me provokuar debat edhe me tekstualizu me çfarë hapësire ky komision do të ketë punë të bëjë, e unë besoj se puna ka me qenë e madhe para komisionit por plotësisht e paqartë prej ftesës është fakti se ne veç do të funksionojmë, apo iniciativa nisma do të funksionojë si një iniciator të një komisioni që do të krijohet prej qeverisë. Ne aso qeverie kemi që unë besoj se as ato nënshkrime nuk kanë me iu nevojit dhe e aprovojnë pa kurrfarë problemi, sepse kjo qeveri është e mbaruar për..... jo vetëm ashtu, por ashtu diçka. Do të thotë nuk ka kurrfarë problemi. Përkundrazi, nënshkrimet janë problem këtu sepse atëherë tregohet që ka një opinion publik e këta donë mos me pas kurrfarë opinionin publik por vetëm partnerët ndërkombëtarë.

Bekim Blakaj: Unë jam Bekim Bakaj. Nuk e kam pas ndërmend fare të marr fjalën, kam dashur të dëgjoj më shumë prej ju artistëve, domethënë idetë tuaja, mirëpo pyetja juaj, domethënë qëllimi i komisionit më shtyri ta marr fjalën. Më falni që bash po dua ta banalizoj kështu krejt, sepse e di që s’kemi kohë për diskutim. Domethënë ka shumë

qëllime. Qëllimi kryesor është se është shumë i nevojshëm. Këtu u fol për paragjykimet, për çështje të ndryshme, për një arabanas që ia ka nxjerr sytë. Edhe ato paragjykime veç po shkojnë dhe po rriten. Çështja tjetër, që është shumë me rëndësi. U përmend shpesh këtu dhe gjithkund e gjithmonë e dëgjojmë – na e dimë çka na ka ndodhë. E dimë, viktimat e dinë më së miri dhe kurrë s'kanë me harrua. Edhe ne e dimë globalisht. Unë që 9 vite merrem me të drejtat e njeriut dhe jam në terren tërë kohën. Gati çdo ditë bisedoj me familjarët e viktimave dhe nuk jam i sigurt që i di të gjitha. S'e di a jeni ju të sigurt që i dini të gjitha çfarë kanë ndodhë. A e dinë në Serbi çka ka ndodhë? Hakia na mori shembullin, tha i ka marrë dy... nejtë s'po më doket mirë po s'ka gajle. Dhe ka has në njerëz që jetojnë në 100 kilometra, po që po e marrim 150 prej këtu dhe kurrë s'janë takuar me shqiptarë dhe nuk e dinë çka ka ndodhë, tek ata nuk e dinë çka ka ndodhë. Në Serbi mendojnë, domethënë një pjesë e madhe, se viktimat më të mëdha kanë qenë serbët në Kosovë. Këtu ke njerëz që thonë serbë nuk ka pas, nuk ka pas asnjë viktimë serbe. Prandaj është e nevojshme që, së paku, unë mendoj ashtu, prandaj jam përkrahës shumë i madh i idesë për krijimin e një komisioni të tillë që u dëgjua e vërteta në nivel të rajonit, që dikush në Shumadi, një fshat i Shumadisë me dëgjua një viktimë shqiptare prej burgut të Dubravës që tregon qysh forcat serbe i kanë vra të burgosurit. Kjo nuk follet as këtu e le më në Serbi, as në Kroaci, as në vende tjera. Domethënë kjo është. Mandej, Sara e përmendi shkarazi, krijimi i një platforme për viktimat, ku ato, pra viktimat duhet me i nxjerrë nevojat e tyre, cilat janë nevojat e tyre se këtu për viktima më askush s'po flet, pos Petriti që e ka bërë një këngë... Thash nuk po dua se ka shumë për t'u folur për këtë çështje. Gjithsesi nëse komisioni krijohet, nëse qeveritë e shteteve të dala prej ish-Jugosllavisë e krijojnë një komision megjithatë do të jetë një komision që do ta nxjerr një të vërtetë, që do të nxjerr një raport dhe ideja është qysh ka ndodhur në shumë vende, ai raport është hy në kurikulum me u edukuar gjeneratat e reja për atë çka ka ndodh në mënyrë që mos të përsëriten më. U përmenden krimet e luftës së dytë botërore, pas luftës së dytë botërore. Unë në shkollë s'i kam mësuar, s'e kemi pas të lejuar dhe krejt këto probleme janë futur ndër tepih e që më vonë edhe më shumë i ka rritë ato ndjenjat të urrejtjes të them ndaj tjerëve. Domethënë kjo pastaj kishte për të ndikuar në relaksimin e raporteve, kur të dëgjohet kjo e vërtetë. Sepse, megjithatë të gjithë jemi njerëz dhe të gjithë kur te shohim sikur atë gruan sot që tregonte qysh i ka ndodh, pa marrë parasysh prej kahit vjen, e kemi njëfarë bashkndjenje. Më falni që isha shumë i gjatë. Faleminderit!

Sarah Maliqi: I kemi edhe dy folës, veç masi e kemi kaluar kohën, ndoshta më shkurt. Visari e pastaj Xhaferi.

Visar Krusha: Unë jam Visar Krusha. Unë veç desha të diskutoj pak rreth kësaj çështjeje dhe çka mund të bëjnë artistët. Ky konteksti pse duhet me u bë ky arkivimi apo mendoj mbledhja e fakteve për viktimat, besoj se nuk duhet të diskutohet shumë, ajo po dihet. Mendoj konteksti politik në rajon dihet çfarë është. Me pas bashkëpunuar qeveritë, vetëdija, stereotipat, paragjykimet nuk janë sende që mund të bëhen, po mendoj aq shpejt dhe kjo pjesa çka mund të bëjnë artistët mendoj se ndoshta është një problem në këtë rast por po mendoj se qysh kanë me fol ato viktima sepse te ne është bajagi problem njerëzit me fol. Unë e di që ka gra të dhunuara e që askush kurrë nuk ka fol. Domethënë ndoshta në njëfarë mënyre artistët kishin me u përfshi në aktivitetin qysh me kuraj njerëzit që të flasnin sepse ajo është mirë për ta, ajo është e drejtë e tyre, ajo i çliron dhe ndoshta më vonë edhe iu jep ndonjë kompensim material.

Në këtë rast, në këtë kontekst, ndoshta duhet me pas pak fondacione më shumë për aktivitete artistike për shfaqje, filma e kështu diçka. Faleminderit!

Sarah Maliqi: Po ia jap fjalën Xhaferit dhe pastaj përfundojmë sepse dreka është duke na pritur.

Ylber Maxhuni: Ju përshëndes edhe një herë. Jam Ylber Maxhuni, nga Organizata “Youth step”. Ajo që më shtyri me marrë fjalën prapë është diskutimi i parafolësve sidomos i artistëve dhe desha me u fokusuar në rolin e artistëve. Zotëri Pashoviq shumë mirë e argumentojë, në mënyrë filozofike dhe komparative rolin e artistëve, si luftëtarë të drejtësisë. Parafolësi tha se e bëri një krahasim në mes balerinës. Unë mendoj se duhet t’i merret balerinës topi dhe t’i jepen këpucët e baletit. Dhe, për artistët mendoj se do të lidhem me një thënie të gjeniut francez dhe shkrimtarit të njohur të romantizmit Viktor Hugo, i cili thotë nuk ka zhvillim pa ndarje. Andaj, funksionet duhet të jenë të ndara. Artistët e kanë një rol të pazëvendësueshëm dhe të papërsëritshëm në qëllimin e këtij komisioni andaj artistët paraqesin një element bazik për funksionimin e komisionit në të ardhmen dhe duhet të jenë një lloj psikologu të përgjithshëm skenik jo sikurse psikologët e përfshirë të cilët do të mundohen t’i trajtojnë viktimat mirëpo ta paraqesin realitetin.

Natasha Kandiç: Unë mendoj se nuk kemi mjaft kohë në përgjithësi për një diskutim të tillë. Përshtypja ime është që nuk është e qartë nisma e jonë, por që ekziston ajo është që çdo njëri nga ju ka disa kërkesa shumë më të forta dhe nuk është e gabuar ose unë të them se plotësisht e kuptoj se tek disa ekziston ndjenjë e fortë marrëdhënie në lidhje me gjithë ata që ishin në ish-Jugosllavisë ndaj shqiptarëve dhe për të gjithë e kanë atë ndjenjë ata të gjithë janë në termë të njeriut janë të lënduar dhe se nuk është e lehtë për tu mbajtur. Po, dhe unë absolutisht bie në dakord se ka pasur një marrëdhënie të tillë. Absolutisht, kjo është plotësisht e dukshme vetëm kur përcillet nga viti 1991 deri tek këtu si ishte një marrëdhënie. Këtu ka elemente marrëdhënie të racizmit . Unë plotësisht, plotësisht e kuptoj, dhe gjithmonë ka qenë e tmerrshme , sepse kjo është parë dhe në terren . Të gjithë ata që merren me të drejtat e njeriut kanë qenë të aftë për të parë. Dhe atëherë kur vijë dhe lufta, kur të vijë nxitje politike të urrejtjes dhe pastaj vritet për shkak këtyre besimeve racore, por kur ishte në vitin 1999 atëherë definitivisht kanë mundur të shihen dy gjëra: Për ta vrarë shqiptarin nuk është një krim. Të vriten shqiptarët për shkak se ata e kanë sjell NATO-n. E tash cila është arsye më e rëndësishme për ta që kanë vrarë deri tani me të vërtetë nuk kam arritur të kuptoj, por këto dy gjëra kanë qenë dominante. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që tani duhet të qëndrojnë të burgosurit e kësaj . Ne kemi nevojë për të komunikuar. Ne nuk mund të nisemi nga viti 1912. Këtu nuk është bërë asgjë. Dha ejani pra për të bërë një hap të vogël, çfarë mund të bëjmë. Ne nuk jemi qeveri. Mua më ka ardhur pakëz keq tani për qeverinë e Kosovës sa jeni ... Për nder, kur nuk më ka ardhur keq për as një qeveri , gjithmonë përbuzi çdo qeveri në Ballkan, dhe tani përnjëherë ju e paraqitni sikur kur Tina Kajdanov e thërret... Pak e keni kërkuar por ani. Në rregull , pak e keni tepruar por mos të merremi më qeveritë, do të vijë koha kur ne me këtë iniciativë , ne mund ta kemi strategjinë dhe lobimin, dhe të gjitha këto. Kjo është shumë larg neve ... Na jepni diçka që është konstruktive. Herën e parë, pas të gjitha këtyre luftërave, ne kemi një lidhje të fortë rajonale në kornizë të iniciativës. Ne duam fakte, ne duam të vërtetën, ne duam që të shkarkojmë një barrë të tmerrshme Është i rëndësishëm jo vetëm arsimi, thjesht nuk ka bashkësi njerëzore, nuk ka një përparim, nëse ne nuk do të bëjmë diçka, nëse them se nuk mund të prosperojmë për shembull në Serbi ... Jo së nuk e din! Ju lutemi, aq shumë kishte polici

dhe ushtri në Kosovë, për atë ata e dinë. Ata e dinë se ku kanë vjedhur, mënyrën së si kanë vrarë. Ndoshta nuk e dinë ndonjë fshatarë Shumadi, por të gjitha duhet të jenë diku në polici. Të gjithë ata heshtin. Dhe në qoftë se dhe ne heshtim dhe ne themi se unë nuk do të kemi punë me juve për shkak se futbollisti nga Kosova nuk luan në Beograd nuk dëshirojmë të bëjmë asgjë, pastaj duhemi, pastaj dëshirojmë. Pra, e gjithë kjo do të kontribuojë që politikanët serb ti sjellim në situatë që ata të e kuptojnë, të flasin, të përsërisnin për çdo ditë që nuk ka asnjë lidhje me ndonjë mençuri. Çfarë krahine serbe, çfarë territor serb, ju lutem. Kjo është plotësisht e qartë të gjithëve përpos politikanëve serbe. Dhe ju mendoni se njerëzit në Serbi besojnë se Kosova është pjesë e Serbisë, nuk janë të çmendur. Por me politikanët është diçka tjetër. Ata do të mbështjellin këtë deri sa nuk e pranojnë një lëkundje të fortë të tyre për të qëndruar në pushtet, dhe pastaj do të ndodhë diçka që do të ndryshojë. Por kjo nuk duhet të na pengojë neve që të përpiqemi ta bëjmë këtë presion dhe në këtë mënyrë. Unë nuk shoh një instrument më të fortë se sa ky për ushtrimin e presionit. Dhe mendoj se nuk ka asgjë më të rëndësishme. Aq shumë njerëz u vranë. Unë detyrohem, dhe për atë do të punoj pavarësisht se ju do të më thoni mua por ti je Serbe. Mua më intereson se çka kishte ndodhur me Fehmi Aganin. Nëse të gjithë ne jemi në atë nivel atëherë unë mendoj se ne mund të bëjmë diçka. Unë gjithmonë do të jem shumë, t'u them shumë faleminderit, ju jeni artistë, unë nuk jam në gjendje të bëjë asnjë vepër artistike, nuk mund të bëjë një film, nuk di ... por tani kur dëgjova se e kishte bërë një këngë për të zhdukur, kjo më shqetësoi ... dhe pa durim pres ta pyes çka është ajo, dhe ta shoh atë.. Por mendoj se ne nuk jemi të ndarë ... Se ne jemi disa që u morëm me gjëra të zakonshme, me viktime dhe ju i takoni një bote të zgjedhur. Nuk është, edhe ju e keni një rol, edhe ju e keni një përgjegjësi për atë që ne bëjmë. Por mendoj se është keq sepse është ende në fillim dhe nevojitet më shumë kohë për këtë bisedë.

Haris Pashoviq: A mundem shkurtimisht vetëm një fjalë për t'u them se unë shpresoj se herën tjetër do të kemi edhe më shumë artistë nga Bosnja, nga Serbia dhe Kroacia, siç kemi pasur në Beograd. Mendoj se për këtë ne kemi nevojë, dhe mendoj se bota më të vërtetë ka nevojë për artistët nga Kosova dhe është e rëndësishme për ne që të shohim dhe të dëgjojmë atë çka ju flitni për përvojën e rëndësishme të juaj. Dhe atë që tha, të gjithë e dimë se çfarë ka ndodhur. A dini çka, të gjithë e dinë atë që ndodhi sot. Për 3 vjet të tjera nuk e di në se do të jetë - të gjithë e dimë se çfarë ka ndodhur. Nëse e ekonomia në tranzicion është më e shpejtë së drejtësia tranzicionale, pastaj ata që sot e dinë se çfarë ka ndodhur ndoshta pak do të harrojnë kur vijnë deri tek paraja e madhe, e dini. Prandaj është e rëndësishme që të ketë një komision që do të jetë i besueshëm, meritor të përcaktojë, dhe pastaj ne mund të vazhdojmë të punojmë. Unë më të vërtetë dëshiroj... Unë ju ftoj sepse ne do të bëjmë ndërrimin e kontakteve, dhe kështu, shumë kisha dëshiruar të qëndrojmë në kontakt, për të këmbyer, për t'u ndihmuar dhe unë disa nga kontaktet e mia, ose ju mua me kontaktet e juaja, dhe unë më të vërtetë kisha pasur dëshirë, nëse të gjithë së bashku e bëjmë situatën që fëmijët tuaj mos të mendojnë se fjala serb do të thotë njeriu pa të drejta, si unë që mendoja se fjala Shiptar do të thotë hamall. Dëshiroj që fëmijët tuaj nuk mendojnë kështu dhe ju fëmijë të juaj, të rinjtë në të ardhmen fëmijëve të tyre mos t'u thoin Fli së do të vjen serbi. Atë herë ne kemi ndryshuar diçka, atë herë e kemi bërë një hap nëse ne diku e kemi këputur këtë zinxhir, në qoftë se e këna kaluar këtë drejtim dhe në qoftë se ne i kemi hapur disa mundësi të reja. Unë më të vërtetë mendoj se artistët në Kosovë, artistët në Bosnje artistët kanë mundësin

dhe përgjegjësinë më të madhe për ta bërë këtë. Faleminderit! Ka qenë shumë interesante dhe për mua ishte shumë emocionuese për të dëgjuar këtë çka ju e thatë.

Sarah Maliqi: Faleminderit. Për sot e kryem. Faleminderit për kontributin e dhënë. Dreka është gati. Faleminderit, juve përkthyes!